



“BIZNES PLANI STRATEGJIK”
PËR
AUTORITETIN SHTETËROR
TË INFORMACIONIT
GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI

2015-2020



Ky dokument është hartuar për **Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor** (ASIG) i cili është edhe institucioni përgjegjës për zbatimin e tij. ASIG është institucion qëndror publik në varësi të Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, i krijuar në vitin 2013.

ASIG ka autoritet politikbërës, vendimmarrës, koordinues, dhe mbikqyrës për çështjet që lidhen me gjeo-informacionin (GI) dhe ofrimin e tij, duke plotësuar kërkesat e përdoruesve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare dhe rritjes së mirëqënies së shtetasve të saj.



Realizimi i “Biznes Planit Strategjik për ASIG” është financuar nga qeveria e Norvegjisë, si pjesë e iniciativës dhe projektit për ngritjen dhe zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI) në Shqipëri dhe përmes Autoritetit Norvegjez të Hartografisë dhe Kadastrës “**Statens Kartverk**”.

Norvegjia është shteti me infrastrukturën më të zhvilluar për gjeo-informacionin dhe luan rolin e partnerit udhëheqës dhe konsultues për shumë shtete të cilat janë në proces themelimi të NSDI-së në vendet e tyre.



Shërbimi i konsulencës për zhvillimin e “Biznes Planit Strategjik për ASIG” është ofruar nga **Magnum Opus Group (MOG)**, sipas kontratës së lidhur më 15 shtator 2014. MOG është një kompani shqiptare, që operon në treg që nga viti 2011, duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë në manaxhim projektesh dhe ofrim konsulence në fusha të ndryshme të ekspertizës.

Në ofrimin e shërbimit të kontraktuar MOG ka bashkëpunuar ngushtësisht me ASIG si përfitues i shërbimit, me financuesit “Statens Kartverk” dhe ekspertët e tyre, si dhe me aktorët kryesorë të sektorit të gjeo-informacionit në Shqipëri.

I gjithë procesi është zhvilluar nën vëmendjen dhe drejtimin e znj. Milena Harito, **Ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike** si dhe, me bashkëpunimin dhe kontributin e veçantë të **BIG** (Bordi për Informacionin Gjeohapësinor). “Biznes Planit Strategjik për ASIG 2015-2020” është shqyrtuar dhe miratuar nga BIG në mbledhjen e datës 16.07.2015.

Përmbajtja

1. HYRJE	1
1.1 Shqipëria dhe NSDI	1
2. PROCESI	2
2.1 Qasja	2
2.2 Metodologjia	3
3. PERSPEKTIVA E GJERË DHE E INTEGRUAR	5
3.1 Vështrim i përgjithshëm	5
3.1.1 ASIG	5
3.1.2 Biznesi i ASIG	8
3.1.3 Biznes Plani i ASIG-ut.....	10
3.2 Nevoja e Biznesit	12
3.2.1 Kërkesa	12
3.2.2 Oferta	13
3.2.3 Diferenca/Hendeku	15
4. PLANI STRATEGJIK.....	18
4.1 Perspektiva e Gjerë dhe e Integruar	18
4.1.1 Qëllimi	18
4.1.2 Vizioni	19
4.1.3 Misioni.....	24
4.2 Qëllimet & objektivat	25
4.2.1 Qëllimi i Përgjithshëm	25
4.2.2 Qëllimet Strategjike	25
4.2.3 Objektivat	27
4.3 Strategjia	30
4.3.1 Principet	30
4.3.2 Prioritetet.....	32
4.3.3 Rrugëtimi.....	33
5. PLANI I MANAXHIMIT	37
6. OBJEKTI I PUNËS SË SISTEMIT TË INTEGRUAR	39
6.1 Vështrim i Përgjithshëm.....	39
6.2 Deklarata e Objektivit	40

6.2.1 Gjeoinformacioni (GI) & Cikli i tij i Jetës	40
6.2.2 Sistemi i GI & Cikli i Jetës së tij	41
6.3 Struktura e Zbërthimit të Punës	44
6.3.1 Nivelet e SZP	44
6.3.2 Përshkrimi i SZP	46
7. OBJEKTI I PUNËS SË ASIG	53
7.1 Struktura e Zbërthimit Organizativ të Sistemit të GI	53
7.2 Nivelet Hierarkike të Sistemit	54
7.3 Matrica e Caktimit të Përgjegjësisë	56
7.4 Propozime për Ristrukturim (BIG / ASIG)	59
7.4.1 Propozimi për Strukturën e Nivelit Udhëheqës	59
7.4.2 Propozimi për Strukturën e Nivelit Drejtues	61
7.4.3 Propozimi për Strukturën e Nivelit Manaxherial	61
7.4.4 Propozimi për Strukturën e Nivelit Operacional	65
8. PROGRAMI I PUNËS / PERFORMANCA NË KOHË	66
8.1 Aktivitetet	66
8.2 Diagrama Rrjet	66
8.3 Vlerësimi i Burimeve & Programi	67
9. BUXHETI / VLERËSIMI I KOSTOVE	70
9.1 Analizimi i Kostove	70
9.2 Buxheti i ASIG	70
9.2.1 Shpërndarja e buxhetit në paketa pune	71
9.2.2 Shpërndarja e buxhetit në vite	75
10. MANAXHIMI I RISKUT	77
10.1 Risqet e Identifikuara	77
10.1.1 Kërcënimet	77
10.1.2 Oportunitetet	77
10.2 Manaxhimi i Riskut	78
11. Aneksi 1 - DETAJIMI I BUXHETIT TË BPS-SË	80

LISTA E AKRONIMEVE

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
ALBPOS	Sistemi Shqiptar i Pozicionimit Global
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BE	Bashkimit European
BIG	Bordi i Informacionit Gjeohapësinor
BNj	Burimet Njerëzore
BPS	Biznes Plani Strategjik
DEM	Digital Elevation Model (Modeli Dixhital i Lartësive)
DIKW	(Data, Information, Knowledge, Wisdom) (Të dhëna, Informacion, Njohuri, Mençuri)
INSPIRE	INfrastructure for SPatial InfoRmation in Europe (Infrastruktura për Informacion Hapësinor në Europë)
GI	Gjeo-Infomacion
GIS	Geografic Information System (Sistemi i Informacionit Gjeografik)
KM	Këshilli i Ministrave
KRGJSH	Korniza Referuese Gjeodezike e Shqipërisë
MCP	Matrica e Caktimit të Përgjegjësisë
MIAP	Ministër për Inovacionin dhe Administratën Publike
M&K	Monitorim dhe Kontroll
NSDI	National Spatial Data Infrastructure (Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Gjeohapësinore)
QA/QC	Quality Assurance/Quality Control (Sigurimi i Cilësisë/ Kontrolli i Cilësisë)
QP	Qëllimi i Përgjithshëm
QS	Qëllimet Strategjike
RSH	Republika e Shqipërisë
SK	Statens Kartverk (Kartverket)
SZB	Struktura e Zbërthimit të Buxhetit
SZO	Struktura e Zbërthimit të Organizatës
SZP	Struktura e Zbërthimit të Punës
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

***Shënim:** Për arsye se disa terma ose institucione njihen dhe përdoren në anglisht edhe në ‘gjuhën’ e gjeoinformacionit në Shqipëri, është vendosur që të përdoren të tillë edhe në këtë dokument. Në kllapa ‘ () ’ gjendet përkthimi në gjuhën shqipe.*

1. HYRJE

1.1 SHQIPËRIA DHE NSDI

Gjeodezia, hartografia, prodhimi i informacionit gjeografik në formë dixhitale, rezultojnë të shpërndara ndëmjet shumë agjencive ekzistuese në Shqipëri, ndërsa aksesit ndaj informacionit gjeohapësinor të përditësuar është shumë i ulët. Në vitin 2013 u ngrit Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), duke operuar me numër të kufizuar në staf deri në vitin 2013-2014, ndërsa gjatë vitit 2015 numri i punonjësve është duke u rritur.

Qeveria e Norvegjisë, përmes Autoritetit Norvegjez të Hartografisë - Statens Kartverk (SK), po mbështet ASIG-un edhe në përgatitjen e Biznes Planit Strategjik (BPS), duke synuar përcaktimin e vizionit afatgjatë dhe planit të punës, duke qartësuar përgjegjësitë dhe prioritetizuar aktivitetet për ASIG-un për pesë vitet e ardhshme.

BPS-ja do të shërbejë si bazë për vendimmarrjen e qeverisë mbi ndarjen e përgjegjësisë dhe për shkëmbimin e informacionit, të nevojshme për një Infrastrukturë Kombëtare të Dhënash Gjeohapësinore (NSDI) funksionale në Shqipëri, në përputhje me situatën ekzistuese, prioritetet e nevojshme për informacion gjeohapësinor, burimet e kufizuara të ASIG-ut dhe institucioneve të tjera të cilat prodhojnë informacion gjeohapësinor, dispozitave të kuadrit ligjor shqiptar dhe kërkesave të Bashkimit Europian.

Qëllimi kryesor i ASIG-ut është ngritja e përhershme e NSDI-së në Shqipëri në të njëjtën linjë me infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore në Bashkimin Europian, duke zhvilluar mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe organizatat të cilat janë të përfshira dhe janë përgjegjëse për mbledhjen, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor, si dhe monitorimin dhe manaxhimin e punës përkundrejt kërkesave të përdoruesve kryesorë, grupeve dhe qytetarëve. Një vizion i përbashkët dhe politika të qarta të biznesit midis pjesëmarrësve në procesin e ngritjes së NSDI-së, janë të nevojshme për zhvillimin e suksesshëm të tij (përfshirë qasjen e përbashkët për zgjidhjen e problemeve, rritjen e vetëdijes dhe kuptimit të përfitimeve që sjell NSDI-ja, partneritetin e përgjegjshëm midis pjesëmarrësve, qëllimet realiste për implementimin e ardhshëm të planit dhe mbështetjen manaxheriale në të gjitha nivelet).

2. PROCESI

2.1 QASJA

Qasja për përcaktimin e perspektivës së gjerë është bazuar në 5 linja kryesore:

- a) **Qasja e “Integruar”**: i gjithë sistemi i gjeo-informacionit në Shqipëri duhet të shikohet nga perspektiva e integruar, duke synuar integrimin e informacionit dhe analizave lidhur me dokumentet strategjike qeveritare, grupet e interesit, infrastrukturën e sistemit, proceset dhe outputet. Kështu ofrohet një panoramë multidimensionale e sistemit ekzistues të gjeoinformacionit në Shqipëri, dhe duke mundësuar një perspektivë të integruar nga këndvështrime të ndryshme.
- b) **“Qasja Sistem”**: duke qenë të vetëdijshëm mbi faktin që analizat e thjeshta dhe raportimi janë të pamjaftueshme, synimi është projektimi dhe ngritja e një sistemi pune për ASIG-un dhe aktorët kryesorë, përfshirë donatorët, me qëllim për të vendosur bazën e një sistemi të integruar të gjeoinformacionit.
- c) **“Qasja HD”**: të gjitha çështjet trajtohen me thellësi, duke i kushtuar vëmendje maksimale edhe detajeve më të imëta, me synim që informacioni të mblidhet dhe zbërthehet në mënyrë analitike. Kështu ofrohet pamja HD (*High Definition*) e sistemit të informacionit gjeohapësinor, duke mundësuar bërjen e kombinimeve të ndryshme.
- d) **Qasja “Think Big”**: të parit ‘pikturën e madhe’, dhe të qenit i orientuar dhe duke lëvizur drejt saj, pamvarësisht situatës ekzistuese dhe hapave të shumtë që duhen ndjekur. Sot hidhen bazat, por duke pasur në mendje ‘pikturën e madhe’ të së nesërme (as pjesërisht dhe as të vogël).
- e) **Qasja “Mendo Ndryshe”**: është qasja për të bërë të mundur ndryshimin e situatës ekzistuese. Nëse problemet e më shumë se 20 viteve do vazhdohen të trajtohen në të njëjtën mënyrë, me siguri rezultati do të jetë i njëjtë si gjatë dy dekadave të kaluara. Siç është cituar nga novelisti amerikan JD Houston: *“Nëse dëshironi diçka në jetë që nuk e keni patur kurrë, ju duhet të bëni diçka që nuk e keni bërë kurrë më parë”*.




2.2 METODOLOGJIA

Biznes Plani Strategjik është konceptuar dhe zhvilluar duke ndjekur metodologjinë dhe metodat e mëposhtme, si instrumente për të mbledhur dhe përpunuar informacionin:

- Situata ekzistuese:** bazuar në informacionin e siguruar nga Raporti i Vlerësimit mbi situatën aktuale, gjetjet & sugjerimet e identifikuara mbi: (i) strukturën/grupet e aktorëve (ii) infrastrukturën e sistemit (iii) proceset & outputet (IV) strategjitë kyçe, politikat, programet dhe planet të cilat ekzistojnë dhe shërbejnë si guidë për ASIG-un dhe japin një pamje të përgjithshme të NSDI-së ekzistuese në Shqipëri.
- Praktikat më të mira ndërkombëtare:** janë analizuar Strategjitë Kombëtare të mbi 15 shteteve të Evropës, 6 të Amerikës, 3 të Azisë dhe të Australisë.
- Bazuar në eksperiencën e Norvegjisë:** si shtet me infrastrukturë GI të zhvilluar dhe që luan rolin e partnerit udhëheqës dhe konsultues për shumë shtete të cilat janë në proces ngritje të NSDI-së në vendet e tyre, përfshirë edhe Shqipërinë dhe konkretisht fazën e planifikimit përmes BPS-së. Për këtë qëllim u zhvilluan takime dhe prezantime në Norvegji gjatë periudhës 28-31 Janar 2015, me fokus veprimtarinë e Kartverket & strategjinë e re “Destinacioni 2025” si dhe diskutime mbi sfidat reale të Gjeoinformacionit (GI) në Shqipëri.

Informacioni mbi situatën ekzistuese u përmbledh dhe u klasifikua duke përdorur teknikën e “Pemës së Problemit”. Kjo teknikë është përdorur për të mbështetur planifikimin dhe është në të njëjtën linjë me qasjen “**Sistem**” dhe “**HD**” që drejtojnë mendimin për ngritjen e NSDI-së në Shqipëri. Ndërkohë që informacioni për praktikat më të mira ndërkombëtare u përpunua përmes “Analizës Krahasuese të Dokumentacionit”.



3. PERSPEKTIVA E GJERË DHE E INTEGRUAR

3.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

3.1.1 ASIG

Sipas ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në RSH", Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është institucion qëndror publik me personalitet juridik, në varësi të Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, dhe financohet nga Buxheti i Shtetit si dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Si autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor, ASIG-u vepron si autoritet vendimmarrës, ekzekutiv dhe koordinues, mbikëqyrës i zbatueshmërisë së kornizës ligjore shqiptare të gjeoinformacionit (GI) si dhe përfaqësues i shtetit për të gjitha çështjet që lidhen me infrastrukturën e gjeoinformacionit.


Qëllimi i ASIG-ut është ngritja dhe zhvillimi i NSDI-së në Shqipëri, sipas rregullave dhe standardeve Europiane, duke mundësuar një infrastrukturë të hapur, bashkëpunuese për aksesimin dhe shpërndarjen e gjeoinformacionit dhe shërbimeve online.

Në vijim të dokumentit të politikave "Për krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore - NSDI" (VKM nr. 144, datë 22.02.2012), është miratuar legjislacioni përkatës, që përshkruan përgjegjësitë e autoritetit të ri. Por pjesa më e madhe e akteve nënligjore nuk janë aprovuar akoma (75% e akteve nënligjore të parashikuara nga Ligji 72/2012), duke iu referuar akteve mbi:

- ✓ Rregullat për metadatat dhe afati i zbatimit vs. 35 temat (të aprovuara vetëm për Kornizën Referuese Gjeodezike-KRGJSH);
- ✓ Standardet uniforme dhe rregullat e infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor;
- ✓ Rregullat e detajuara për zbatimin e ndërveprueshmërisë;
- ✓ Rregullat për shkëmbimin e grupeve & shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore midis autoriteteve publike;
- ✓ Udhëzime për tarifën e shërbimeve të konsultimit (realizimi i vlerësimeve, mënyra rregulluese/afati për pagimin, kriteret përjashtuese për shkak të kostove të larta të prodhimit dhe përditësimit të të dhënave);
- ✓ Rregullat për Gjeoportalin Kombëtar (ngritja, mirëmbajtja dhe aksesimi).



1 Tetor 2013 ishte afati i fundit për miratimin e tre akteve të para të përmendura më sipër, ndërsa 1 Janar 2014 ishte afati për tre aktet e fundit.

ASIG-u ka funksionuar me numër të kufizuar stafi gjatë viteve 2013-2014, por numri i stafit është parashikuar i rritur për vitin 2015. Duke konsideruar edhe transferimin e mundshëm të ALBpos-it tek ASIG-u, për vitin 2015 është parashikuar një organogramë e re me 29 punonjës (që përmban 2 drejtorë dhe 7 sektorë, ku një sektor i vetëm do i dedikohet ALBpos-it), që nënkupton në shifra rreth 14 punonjës shtesë për ASIG-un.



Sipas organogramës së re të ASIG-ut dhe numrit të rritur të punonjësve, buxheti për vitin 2015 ka patur një rritje krahasuar me vitin 2014 (buxheti i plotë i ASIG-ut për vitin 2015 parashikon një fond prej 112,770,000 lek). Referuar projekteve të investimeve publike të ASIG-ut, në draftin e Buxhetit Afatmesëm 2015-2017 është përfshirë ngritja e Rrjetit Gjeodezik Shqiptar dhe zhvillimi i sistemit të ALBpos-it (duke alokuar shumën totale prej 120 milion lekë).

Qeveria e Shqipërisë ka financuar fazën e parë të projektit për Kadastrën Multifunkionale (3 milion Euro) me qëllim që të sigurojë Ortofoton Dixhitale 2D/3D (lidar scanning) për territorin e Shqipërisë brenda vitit 2015, duke përdorur sistemin referues të ALBPOS dhe sipas Direktivës INSPIRE të BE-së. Të dhënat do të shërbejnë si bazë për përditësimin e përgjithshëm nga të gjithë autoritetet përgjegjëse sipas temave përkatëse.



Aktualisht ASIG-u ka asistencën e Qeverisë së Norvegjisë përmes Projektit “Asistencë për ngritjen e Autoritetit Kombëtar të Hartografisë për Shqipërinë” 2014-2016 (1.2 milion Euro), për: zhvillimin e biznes planit strategjik; përmirësimin e kornizës bazë gjeodezike; përmirësimin dhe harmonizimin e të dhënave ekzistuese në një burim të vetëm të integruar, pranë ASIG-ut; zhvillimin e zgjidhjeve teknike për ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave për përdoruesit, dhe për shkëmbimin elektronik me institucionet e tjera publike dhe private; zhvillimin e gjeoportalit kombëtar me funksione siç janë specifikuar në programin INSPIRE të BE-së; garantimin e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare për përditësimin dhe dokumentimin e të dhënave (metadata); ndihmuar ASIG-un gjatë marrjes së sistemit për përdorimin e teknologjive të pozicionimit satelitor (ALBPOS) për vëzhgime dhe hartografi, dhe për t’a mbajtur atë në operim

për përdoruesit; për të ndihmuar Shqipërinë në zhvillimin e strategjisë dhe mekanizmave të NSDI-së në përputhje me Direktivën INSPIRE të BE-së, dhe për ta bërë partner aktiv në Programin INSPIRE të BE-së.

Për vitin e kaluar 2014, objektivat e ASIG ishin si më poshtë:

- ✓ Ngritja e kornizës referuese gjeodezike Shqiptare sipas standardeve evropiane për të mundësuar mbështetjen e një hartë unike për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ Krijimi i infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet gjeoportalit ku çdo kush do mund të aksesojë të dhënat gjeohapësinore që shteti shqiptar posedon;
- ✓ Përpilimi dhe zhvillimi i standardeve në fushën e gjeoinformacionit (GI) si dhe implementimi i tyre nëpër institucione, qofshin ato prodhues apo përditësues të gjeoinformacionit.

Në ndjekje të objektivave të mësipërme, arritjet më të rëndësishme të punës dhe aktiviteteve të ASIG-ut për vitin 2014 janë:

1. Ngritja e Gjeoportalit Kombëtar për shkëmbimin e të dhënave gjeohapësinore, i cili është i aksesueshëm përmes adresës web <http://geoportal.asig.gov.al>;
2. Procesi i fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë & Skanimi LIDAR, financuar nga qeveria e Shqipërisë me një vlerë prej 3 milion Euro;
3. Skanimi i sipërfaqes së detit, projekti i përbashkët midis Institutit Gjeografik Ushtarak dhe Statens Kartverk, me vlerë prej 1.2 milion Euro;
4. Hartimi i projektit për konceptimin e programit mësimor të Departamentit të Gjeodezisë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Civile – financuar nga Statens Kartverk;
5. Hartimi për herë të parë i VKM-së për Fondin e kompensimit fizik nga Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave (AKKP), për 23,200 hektar dhe i përbërë nga 23,400 të dhëna (rekorde) dhe poligone;
6. Fillimi i punës për hartimin e Biznes Planit Strategjik për ASIG-un (financuar nga Statens Kartverk dhe kontraktimi i “MOG” si konsulent);
7. Fillimi i punës për hartimin e projekteve teknike për ndërtimin e Kornizës Referuese Gjeodezike (KRGJSH).

3.1.2 Biznesi i ASIG

Implementimi i NSDI-si në Shqipëri është përgjegjësi e ASIG-ut, duke konsideruar gjithashtu fushën e përgjegjësive së aktorëve të tjerë lidhur me mbledhjen, procesimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore, që aktualisht janë të administruara nga shumë institucione të ndryshme. Qëllimi kryesor i ASIG-ut është ngritja e përhershme e infrastrukturës kombëtare e të dhënave gjeohapësinore në të njëjtën linjë me infrastrukturën e Bashkimit Europian (BE). Me synim arritjen e këtij qëllimi duhen zhvilluar mekanizmat bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e përfshira në mbledhjen, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor, si dhe në monitorimin dhe rregullimin/përshtatjen e punës sipas kërkesave të përdoruesve kryesorë, grupeve dhe qytetarëve.


Përgjegjësia kryesore e ASIG-ut është koordinimi i punës për të garantuar ofrimin e informacionit i cili është i plotë, i saktë, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë grupet e interesuara. Puna e ASIG-ut konsiston në hartim politikash & vendimmarrje (rregullator dhe certifikues), manaxherial, rekomandues, propozues, etj. Mbi 20 kompetenca/përgjegjësi janë identifikuar nën domeinin e ASIG-ut dhe sipas ligjit, midis funksioneve kryesore përfshihen:

- ✓ Zbaton politikën kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;
- ✓ Është përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike “KRGJSH-2010”;
- ✓ Mer vendime për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor nga autoritetet publike, sipas temave përkatëse dhe administrimin e GI;
- ✓ Përcakton standardet dhe rregullat uniforme për krijimin e GIS-it, për secilën temë, dhe për krijimin e GIS-it Kombëtar, në përputhje me standardet europiane përkatëse;
- ✓ Harton rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të;
- ✓ Siguron ndërveprueshmërinë e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore si dhe harton rregulla të hollësishme mbi realizimin e ndërveprueshmërisë;
- ✓ Siguron bashkërendimin e punës gjatë aktiviteteve dhe marrjes së nismave që lidhen me informacionin gjeohapësinor në sektorin publik dhe privat;
- ✓ Zhvillon dhe administron Gjeoportalin Kombëtar dhe garanton aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- ✓ Kujdeset për edukimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në procesin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe të shpërndarjes së tij tek publiku dhe grupet e interesit.

Vendimmarrja e bazuar mbi informacionin gjeohapësinor është esenciale për qeverisjen e vendit, ku 80% e këtyre vendimeve janë të lidhura direkt me territorin. Nëse informacioni mbi të cilin merren vendimet, është jocilësor dhe i pasaktë, atëherë dhe vendimet do të jenë të tilla, ose të gabuara. Përfitimet që rrjedhin nga një sistem gjeoinformacioni eficient, do të jenë të shumta:

- ✓ Informacion i saktë nënkupton përgjigje të shpejtë ndaj fatkeqësive/katastrofave;
- ✓ Planifikim më eficient dhe përfitime më të mëdha për shoqërinë;
- ✓ Sistemi i saktë i adresave është kritik në rastet e aksidenteve;
- ✓ Planifikimi i transportit kursen kohë dhe para, duke reduktuar impaktin në mjedis;
- ✓ Thjeshtësi për të prodhuar dhe përdorur të dhënat gjeohapësinore;

- ✓ Paqja, krizat dhe luftërat – akses i shpejt ndaj gjeoinformacionit;
- ✓ Manaxhim më eficient i krizave dhe i iniciativave të shpëtimit;
- ✓ Është esencial për forcat e armatosura;
- ✓ Përmirëson cilësinë dhe lehtëson administrimin online;
- ✓ Rrit bashkëpunimin midis njësive të qeverisjes vendore;
- ✓ Nxist çështjet kërkimore dhe lehtëson ato mjedisore;
- ✓ Një bazë e përmirësuar për vendimmarrjen, çon në vendime më të drejta;
- ✓ Etj.



Duke konsideruar përfitimet e mundshme, në tërësinë e madhe të problemeve ekzistuese që duhen zgjidhur përfshihet gjithashtu edhe vetëdija e ulët si e qytetarëve ashtu edhe e qeverisë mbi përfitimet që sjell institucionalizimi i gjeoinformacionit në vendimmarrje.

3.1.3 Biznes Plan i ASIG-ut

Një plan i mirë strategjik duhet të sigurojë shpjegim të qartë se si një ose më shumë qëllime strategjike do të arrihen nga institucioni ose programi. Zakonisht ai paraqet qëllimet afatgjata, qëllimet programore dhe detajon strategjitë specifike që duhet të ndiqen. Analizohen fushat e mundshme të riskut dhe strategjitë specifike për tejkalimin e tyre. Procesi i planifikimit strategjik është përsëritës dhe jep një pamje të qartë midis situatës ekzistuese dhe vizionit të së ardhmes. Rishikimi i Planit Strategjik për të shqyrtuar nivelin e realizimit kundrejt objektivave të dokumentuara, ngre bazat për të siguruar jo vetëm feedback i cili mund të influencojë planifikimin e ardhshëm dhe vendimmarrjen, por gjithashtu shërben edhe si bazë për matjen e performancës. Me këtë BPS-ë, ASIG-u do të zotërojë një kornizë të qëndrueshme, e destinuar prej fillimit për të shërbyer si udhërrëfyes i së ardhmes së gjeoinformacionit, ku nevojat e organizatave dhe të klientëve janë të shërbyera më mirë.

Qëllimet kryesore janë:

- ✓ Të inkurajojë zbatimin e infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore përmes përpjekjeve efektive strategjike dhe planifikimit të biznesit;
- ✓ Të sigurojë udhëzime për aktivitetet e planifikuara (ai siguron një strukturë për “vizatimin” e një rrugëtimi të qartë nga situata ekzistuese drejt vizionit të së ardhmes në një plan-dokument);
- ✓ Të sigurojë një përshkrim të detajuar se si qëllimet dhe objektivat do të arrihen, së bashku me arsyet justifikuese për veprim;
- ✓ Të inkurajojë formimin e partneriteteve dhe aleancave që do të përmirësojnë procesin e planifikimit.

Përdorimi i BPS-së, do të ndihmojë ASIG-un të përshkojë të gjithë procesin e ngritjes së një NSDI-je të cilësisë së lartë dhe efektive në Shqipëri. Po ashtu, do të shërbejë edhe për të gjithë grupet e aktorëve të lidhur me gjeoinformacionin, të përdorin BPS-ën e ASIG-ut si shembull ose si model për të hartuar BPS-të e tyre strategjike.

BPS-ja do të vendosë vizionin afatgjatë dhe planin e punës, duke qartësuar përgjegjësitë dhe priorizuar aktivitetet e ASIG-ut për pesë vitet e ardhshme. Mundësisht Plani do të jetë bazë për vendimin e qeverisë mbi shpërndarjen e përgjegjësisë dhe për ndarjen e shkëmbimin e informacionit, si nevojë për funksionimin e NSDI-së (Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave) në Shqipëri si edhe për shërbimet gjeodezike. Në përcaktimin e vizionit afatgjatë dhe planit konkret të punës për ASIG-un, është e nevojshme që prioritet të vendosen duke marrë parasysh vlerësimet për buxhetin 5-vjeçar, numrin e stafit dhe financimin realist të nevojshëm. Në përfundim, Biznes Plan Strategjik do të shqyrtohet dhe diskutohet nga bordi ndër-ministor për informacionin gjeografik (BIG), duke “formalizuar” kështu marrëveshje midis ASIG-ut dhe institucioneve të tjera për përgatitjen dhe ndarjen e informacionit gjeografik.

BPS-ja do të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

- ✓ Përgatitjen e vizionit afatgjatë të integruar për ASIG-un (*është një deklaratë e kornizës së politikave, dhe që përcakton një numër hapash strategjike që do t'i japin formë të ardhmes së ASIG-ut si autoritet kombëtar udhëheqës për NSDI-në në Shqipëri*);
- ✓ Përgatitjen e planit pesë vjeçar të punës për ASIG-un (*përcakton rolet dhe përgjegjësitë e ASIG-ut, dhe specifikon aktivitetet e priorizuara dhe produktet e shërbimet që duhet*

të sigurohen nga ASIG-u, dhe qartëson aq sa është e mundur rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të tjera publike në përgatitjen dhe sigurimin e informacionit gjeografik dhe shërbimet e tjera që lidhen me të, po ashtu dhe kryerja e punëve gjeodezike dhe shërbimet që lidhen me to).

- ✓ *Vlerësimi i buxhetit 5-vjeçar për ASIG-un (mbështetur në planin real të punës, duke marrë në konsideratë çfarë ASIG-u realisht mund të bëjë me stafin dhe fondet e tij, përfshirë dhe produktet që mund të kontraktohen nga palët e treta, me kostot e vlerësuara, të ardhurat e vlerësuara - nëse ka, dhe shumës së nevojshme nga buxheti i shtetit si dhe fondet potenciale nga donatorët).*

Bazuar në analizën që i është bërë ligjit, prioritetit të nevojave për informacion gjeografik, kërkesave të Bashkimit European, faktit që informacioni gjeografik dhe shërbimet e gjeodezisë deri më tani janë ofruar nga institucione të ndryshme, dhe burimet e kufizuara të ASIG-ut, bëhet shumë e nevojshme përgatitja/hartimi i një biznes plani realist për ASIG-un, si dhe për të qartësuar rolet dhe përgjegjësitë që do të kenë në vazhdim institucionet e tjera të cilat ofrojnë informacion gjeografik në Shqipëri dhe shërbimet e tjera që lidhen me të *(duke qartësuar rolin e ASIG-ut lidhur me prodhimin e të dhënave dhe shërbimeve; marrë në konsideratë ligjin, kërkesat e BE-së, shpërndarjen ekzistuese të aktiviteteve midis agjencive publike dhe planet e tyre të ardhshme - për të qartësuar çfarë ASIG-u do të bëjë me burimet e tij dhe çfarë duhet të bëhet nga institucionet e tjera, për t'u siguruar që nuk do të ketë mbivendosje të prodhimit midis institucioneve të ndryshme publike).*

3.2 NEVOJA E BIZNESIT

3.2.1 Kërkesa

Klientët e produkteve të gjeoinformacionit (GI) janë: (i) të gjithë përdoruesit fundorë që kërkojnë të dhëna gjeohapësinore, (ii) përdoruesit e gjeoinformacionit dhe shërbimeve të ofruara (disa shërbime japin zgjidhje përmes know-how). Kjo është arsyeja përse e gjithë shoqëria mund të konsiderohet si përfaqësuese e përdoruesve finalë ose klientëve të ‘tregut të GI’.

Duke vazhduar përmes konceptit të “shoqërisë” dhe pjesëve integrale të saj, përveçse qytetarët kërkojnë produktet e GI në fusha të ndryshme (pasuritë e paluajtshme, transporti, etj.), po ashtu si klientë janë konsideruar të gjithë aktorët, pavarësisht se janë institucione publike apo private, kombëtare apo ndërkombëtare, ose OJF, pasi të gjithë kanë nevojë për produktin GI për të plotësuar objektivat e tyre sipas temave specifike të interesit. Për këtë arsye edhe autoritetet publike (institucionet shtetërore publike), organizatat kërkimore/akademike ose sektori privat mund të kenë të dy rolet, pra të jenë në rolin e të qenit përdorues të produktit GI, si dhe përgjegjës për të ofruar disa produkte (bazuar në aktivitetin e tyre sipas kompetencave të përcaktuara nga ligji).

“Tregu i GI” i referohet 35 temave të ligjit 72/2012 – i përafuar pjesërisht me direktivën INSPIRE. Përveç “Imazhit të Hartës Bazë”, 34 temat e tjera të mbetura të gjeoinformacionit janë grupuar në kategori në pajtim me klasifikimin e Direktivës INSPIRE.

ANEKSI 1

 Sistemi i adresave	 Emërtimet gjeografike
 Kufijtë e njësive administrative	 Hidrografia
 Parcelat kadastrale	 Zonat e mbrojtura
 Korniza referuese gjeodezike & KGj	 Rrjetet e transportit
 Sistemet e rrjeteve gjeografike	

ANEKSI 2

 Modeli dixhital i terrenit
 Gjeologjia
 Mbulesa e tokës
 Ortoimazheria

ANEKSI 3

 Infrastrukturën bujqësore dhe akuakultura	 Habitatet	 Demografia
 Zonat me përdorim të kufizuar	 Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tyre	 Infrastruktura industriale
 Kushtete atmosferike	 Përdorimi i tokës	 Detet
 Zonat ekologjike	 Meteorologjia	 Pedologjia
 Ndërtesat	 Burimet minerare	 Shpërndarjen e specieve
 Burimet energjitike	 Zonat me rreziqe natyrore	 Njësitë statistikore
 Infrastrukturën për monitorimin e mjedisit	 Hidrologjia	 Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare

Të gjithë përdoruesit fundorë (pavarësisht kategorisë që i përkasin dhe fushës së tyre të interesit), kërkojnë produktet e GI që plotësojnë më mirë nevojat e tyre – që korrespondojnë me karakteristikat dhe funksionalitetet e mëposhtme:

- ✓ I plotë (disponueshmëria e të gjithë produktit të kërkuara të GI, për sa më shumë përdorues të jetë e mundur, pa konfuzion ose mbivendosje midis temave);
- ✓ Në kohë reale dhe në vazhdimësi (i përditësuar & në kohë, shërbim i shpejtë, i shpërndarë në kohë/pa vonesa, lehtësisht i aksesueshëm/i mundshëm dhe akses i shpejtë, si dhe i shërbyer mirë ndaj përdoruesve);
- ✓ Cilësor (i saktë, korrekt, që plotëson nevojat, në formatin e përshtatshëm/i ndërveprueshëm, i kuptueshëm/jo teknik, i përpunuar në një masë të tillë sa të ofrojë zgjidhje të aplikueshme);
- ✓ Kosto efektive (mundësisht shërbime pa kosto financiare);
- ✓ I integruar (me veten e tij, me aktorët, me rajonin, BE-në dhe përtej).

3.2.2 Oferta

Kundrejt kërkesës përshkruar më sipër, në anën tjetër të “tregut të GI” me ofertën e tyre janë pozicionuar siguruesit/furnizuesit e produktit GI të kërkuar (të dhënat, informacioni dhe dhënia e zgjidhjeve përmes shërbimeve). Aktorët që prodhojnë produktet e GI janë të kategorive të ndryshme përfshirë organizatat publike ose private, shtetërore ose OJF, institucione ose agjenci/autoritete. Këta aktorë janë **kategorizuar** si ‘autoritete përgjegjëse’ për të prodhuar dhe ofruar produktet e kërkuara të GI për klientët ose përdoruesit e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, siguruesit kryesorë aktualisht janë duke ofruar produktet e mëposhtme të GI (hartat):

- ✓ Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), siguron produkte hartografike me të dhëna gjeohapësinore për të gjithë territorin e Shqipërisë si: harta treguese me shkallë 1:500, Harta për regjistrimin e parcelave bujqësore me shkallë 1:1000, Harta e Pasurisë së Paluajtshme me shkallë 1:2500.
- ✓ Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) ofron: Harta e vlerës së tokës; Harta e vendimeve për kthim fizik, Harta e vendimeve të njohjes, Harta e fondit fizik për kompensim.
- ✓ Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) siguron: Hartën e përditësuar të ndërtimeve informale, etj.
- ✓ Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë (IGJUSH), siguron: hartat topografike për terrenin, ajrin dhe detin të RSH me shkallë 1:10000 deri në 1:1000000, Harta e Transportit Rrugor në Shqipëri 1:400000 dhe 1:200000, Harta e Kufijve të RSH 1:300000, etj.
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) siguron hartën e burimeve natyrore, të tilla si: Energjia e Rinovueshme, Hidrokarburet, Minierat, Hidro-energji.
- ✓ Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) – Fushë Krujë, siguron: Hartën Dixhitale të përdorimit të tokës sipas zonave kadastrale; Hartën e zonave bujqësore dhe Hartën e përshtatshmërisë së tokës 1:10000 dhe hartat e vjetra të skanuara nga Instituti i mëparshëm i Studimit të Tokës.

- ✓ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), siguron harta 1:200000 të tilla si: Hartat Gjeologjike, Harta mbi shpërndarjen e Metaleve, Harta e Rrezikut Gjeologjik, Harta Hidrologjike, Harta Tektonike, etj.
- ✓ Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), posedon: Hartën e Cilësisë së Ajrit, Hartën e Cilësisë së Ujit dhe Hartën e Mbulesës së Tokës me shkallë 1:200000.
- ✓ Instituti i Statistikave (INSTAT), posedon: Hartën e Kodeve të Rajoneve dhe Hartën e Kodeve të Ndërtesave sipas censusit të vitit 2011.
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), posedon: Hartën e rrugëve bazuar në ortofoton e vitit 2007; Hartën e ndërtesave; Hartën e hyrjeve të ndërtesave dhe Hartën e kufijve Administrativ.
- ✓ Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore pranë Ministrisë së Mjedisit, posedon hartat Topografike për zonat që shfrytëzojnë inertet dhe burimet ujore 1:250000.
- ✓ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) posedon Regjistrin e Planifikimit të Territorit të RSH.

Lidhur me situatën aktuale të infrastrukturës së sistemit, nga 17 institucione vetëm 10 prej tyre iu përgjigjën pyetësorit të NSDI-së, duke treguar që:

- ✓ 9 prej tyre përdorin faqet zyrtare, nga të cilët vetëm 2 japin akses përmes Gjeoportalit;
- ✓ *Lidhur me Harduerët*: 3 institucione përdorin Workstation, 3 institucione përdorin Personal Computer (PC) në rrjet, 1 institut përdor PC veçmas, të palidhur në rrjet;
- ✓ *Lidhur me Databazat*: 2 institucione përdorin MS Access, 3 institucione përdorin Serverin SQL, 1 institucion përdor Oracle.
- ✓ *Lidhur me Softuerin*: 9 institucione përdorin produktet e ESRI, 4 produkte Autodesk, dhe 1 institucion po përpiqet të përdorë paketën Erdas.

Situata ekzistuese në Shqipëri mbi aktorët/grupet e interesit dhe manaxhimin e të dhënave gjeohapësinore, tregon që ofruesit kryesorë dhe ofertat e tyre karakterizohen nga sa më poshtë:

- ✓ Krahas informacionit hartografik të vitit 1986 në Shqipëri, hartave të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit gjatë viteve 1925-1945, si dhe iniciativës së ndërmarrë në vitin 2007 për fotografimin ajror të Shqipërisë, Republika e Shqipërisë nuk ka asnjë informacion të saktë që të mbulojë të gjithë territorin me të dhëna të përditësuar për nivelimin, tokën, nëntokën, ujin dhe hapësirën ajrore.
- ✓ Gjeodezia, prodhimi i hartave dhe gjeoinformacioni – janë të shpërndarë midis shumë agjencive të ndryshme. Ortofoto dhe disa tipe të kufizuara hartash, janë prodhuar më parë për kthimin e pronave tek ish pronarët, si dhe për legalizimin e ndërtimeve informale, etj.
- ✓ Sot, për të siguruar informacion të saktë mbi një parcelë tok, është e detyrueshme që të punohet në të njëjtën kohë me disa harta të prodhuara nga institucionet të ndryshme, si: ZRPP, ALUIZNI, AQTN, IGJUSH, Departamenti i Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore – Fushë Krujë, AKPT, njësitë vendore, etj., ndërkohë që edhe informacioni nuk është identifikuar me një numër unik i cili mund të sigurojë lidhjen e informacionit të të gjithë aktorëve (institucione të ndryshme) për të njëjtën parcelë.
- ✓ Problemet me disponueshmërinë, cilësinë, dhe përputhshmërinë e të dhënave gjeografike dixhitale.
- ✓ Aksesin ndaj informacionit gjeografik - është shumë i limituar.

- ✓ Aktivitetet e mbledhjes së të dhënave janë jo efektive - të dhënat ekzistojnë por është e vështirë të gjenden, pasi në shumicën e rasteve janë të padokumentuara, dhe në format jo të përshtatshëm.

Si konkluzion, situata aktuale e ofertës së GI, tregon që:

- informacioni nuk është i përditësuar dhe rezulton me shumë pasaktësi (*shembuj të pasaktësisë së të dhënave janë: kufijtë administrativ, kufijtë e zonave kadastrale, kufijtë e parcelave të ZRPP-së, ndërtesat*);
- institucione të ndryshme me iniciativën e tyre kanë prodhuar informacion gjeohapësinor me sisteme të ndryshme koordinative (*shumë institucione nuk punojnë me të njëjtin sistem koordinativ dhe hartë bazë – duke krijuar konfuzion dhe mbivendosje të temave, të cilat në shumicën e rasteve janë burim konfliktesh për shoqërinë shqiptare*);
- në shumicën e rasteve është i mangët;
- të dhënat gjeohapësinore ekzistojnë, por janë:
 - pa referenca të sakta;
 - në formë manuale, jo dixhitale;
 - është e pamundur të aksesohen;
- ekzistojnë dhe në formë dixhitale, por nuk janë të përditësuara.


Në lidhje me pamjen e përgjithshme të gjeoinformacionit, rezultati final është: (i) procedura burokratike të pafundme dhe (ii) një shtet me mungesë të inventarit të tij. Për këto arsye, të dhënat dhe informacionet ekzistuese janë të vështira të identifikohen, aksesohen dhe përdoren.

Secili ofruer është përgjegjës për prodhimin e produktit të GI në fushën e tij dhe nuk mund të garantojë ofrimin e të gjithë informacionit të kërkuar. Pavarësisht kësaj, jo të gjithë institucionet përgjegjëse kanë mundësi të ndjekin ciklin e plotë të produktit të GI, por mbulojnë pjesë të tij, ose disa prej tyre mund të ofrojnë vetëm të dhëna gjeohapësinore dhe jo informacion ose zgjidhje/shërbime të gatshme për t'u përdorur për nevojat e shoqërisë. Si konkluzion, secili autoritet përgjegjës, është pjesë e vetëm një copëze të sistemit aktual, dhe nuk mund të shikojë 'pikturën e madhe' dhe sigurisht nuk ka mundësi të manaxhojë të tërë Sistemin – që jep ofertën vs. kërkesës.

Të pozicionuar në një situatë informale dhe me mungesa burimesh informacioni, ekziston një nevojë urgjente për të filluar implementimin e NSDI-si në Shqipëri përmes përfshirjes së ASIG-ut dhe institucioneve përgjegjëse publike, organizatave private, etj. – ku secili prej tyre kontribuon në fushën e tij respektive dhe në të njëjtën kohë këto institucione duhet të bashkëpunojnë në mënyrën më të mirë, me synim ngritjen, manaxhimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Gjeoinformacionit që operon në vazhdimësi.

3.2.3 Diferenca/Hendeku

Diferenca midis **Kërkesave** të shoqërisë vs. **Ofertës** nga furnizuesit përgjegjës, prezanton hendekun aktual në 'tregun e GI', që normalisht duhet të mbushet. Nevojat e 'tregut të GI' prezantojnë Nevojën ekzistuese të Biznesit vs. ASIG. Kjo nevojë biznesi është paraqitur përmes analizës së Pemës së Problemit më poshtë:



Pema e Problemit për ASIG-un

Element bazë për të arritur qëllimin e përbashkët është bashkëpunimi dhe kuptimi i përbashkët midis partnerëve, me synim ngritjen e NSDI-së në Shqipëri. Zhvillimi i suksesshëm i NSDI-së mund të pengohet nga mungesa e një vizioni eficient të përbashkët dhe politikave të qarta të biznesit midis pjesëmarrësve në këtë proces. Për më tepër, ekzistenca e mëtejshme e një sistemi gjeoinformacioni të izoluar, stoku i të dhënave të tepërta/përsëritura dhe që nuk përdoren, mungesa e fondeve dhe në anën tjetër nevoja për rregullim, ndërveprim dhe shkëmbim të të dhënave në të gjithë nivelet, përbën një sfidë shtesë për Shqipërinë.

Një nga sfidat më të mëdha është sigurimi i aksesit ndaj burimeve përmes përshtatjes/rregullimit/bërjes bashkë e të gjithë iniciativave të ndryshme për zhvillimin e NSDI-së. Shumë faktorë influencojnë zhvillimin, duke përfshirë qasjen e përbashkët për zgjidhjen e problemit, rritjen e vetëdijes dhe kuptimit të përfitimeve të NSDI-së, partneritetin e përgjegjshëm midis pjesëmarrësve, qëllimet realiste për planin e zbatimit në të ardhmen dhe mbështetje manaxheriale në të gjithë nivelet. NSDI-ja nuk mund të mirëmbahet dhe përmirësohet nga një institucion i vetëm. Përpjekjet e mirë-koordinuara dhe të rregulluara, duke përfshirë sektorin privat, sektorin kërkimor/shkencor dhe të gjithë nivelet e shtetit, janë të nevojshme për të stimuluar qasje të përbashkët për zgjidhjen e problemit në drejtim të një NSDI-je të suksesshme në Shqipëri. Vendosmëria politike dhe institucionale është parakusht për një zbatim të suksesshëm.

Në fakt, NSDI-ja bazohet në plotësimin e nevojës së lindur nga sistemet e ndryshme të aktorëve, që dëshirojnë të kenë një 'gjuhë të përbashkët' për të kuptuar njëri-tjetrin. Por infrastruktura e të dhënave gjeohapësinore, gjithashtu ka nevojë të manaxhohet dhe drejtohet në mënyrë të plotë dhe të integruar.

Komponentët kryesorë që NSDI-ja përfshin janë:

- ✓ Politikat & Marrëveshjet Institucionale (*qeverisja, privatësia & siguria e të dhënave, shkëmbimi i të dhënave, mbulimi i kostos*);
- ✓ Njerëzit (*trajnimi, zhvillimi profesional, bashkëpunimi*);
- ✓ Të dhënat (*harta bazë dixhitale, tematike, statistikore, emërtimet e vendeve*);
- ✓ Teknologjia (*harduerët, softuerët, rrjeti, databazat, plane teknike të zbatimit*);
- ✓ Zhvillimi i një platforme për konsultim, përdorim dhe shkëmbim informacioni (*dmth. Gjeoportali Kombëtar*).

Përdorimi i mjeteve të qëndrueshme dhe të besueshme për ndarjen e të dhënave gjeohapësinore midis të gjithë përdoruesve, mund të sjellë kursime të konsiderueshme për procesin e mbledhjes së të dhënave, përmirësim të përdorimit të tyre, si dhe vendimmarrje më të mirë. NSDI-ja shikohet si një tërësi e integruar e teknologjisë, politikave, të dhënave, burimeve njerëzore të nevojshme për të promovuar shkëmbimin e të dhënave përmes të gjithë niveleve të qeverisjes, sektorit privat, jofitim prurës dhe akademik.

4. PLANI STRATEGJIK


4.1 PERSPEKTIVA E GJERË DHE E INTEGRUAR

4.1.1 Qëllimi

Qëllimi Final: Qëllimi fundor i qeverisjes së shtetit është të garantojë mirëqenien e qytetarëve të tij, përmes zhvillimit politik dhe social, rritjes ekonomike, efijencës dhe produktivitetit, dhe qëndrueshmërisë në kohë. Individët, organizatat dhe institucionet publike kanë nevojat e tyre për informacion në përgjithësi dhe për gjeoinformacion në veçanti, për të vepruar në mënyrën më të mirë të mundshme, të planifikojnë dhe shpërndajnë burimet në mënyrë më efektive, të përballojnë më mirë risqet (vlerësimi i risqeve dhe zbatimi i masave parandaluese) për t'a bërë jetën e tyre më të sigurt. Informacioni i saktë dhe i plotë mundëson rritjen e efijencës të shumë funksioneve të shoqërisë, duke qenë një nga rrënjët e 'pemës' që kontribuon në rritjen e mirëqenies.

Qëllimi Thelbësor: Sa më sipër, qëllimi i ekzistencës së grupeve të interesit brenda biznesit të gjeoinformacionit, është të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare duke ofruar informacion dhe njohuri gjeohapësinorë (që është i plotë, i saktë, i strukturuar, i unifikuar, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë shoqërinë), në funksion të rritjes së mirëqenies së shtetasve shqiptarë.

Qëllimi i ASIG-ut: Të sigurojë gjenerimin, zhvillimin, dhe furnizimin me informacion dhe njohuri gjeohapësinore, që është i plotë, i integruar, i standardizuar dhe lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë në biznesin e gjeoinformacionit, për të gjithë territorin e Shqipërisë, sipas standardeve Europiane dhe Direktivës INSPIRE.



4.1.2 Vizioni

Vizioni është konceptuar duke marrë në konsideratë qëllimin e ekzistencës së ASIG-ut, Qëllimin Thelbësor dhe Qëllimin Final, funksionet e ASIG-ut dhe përgjegjësitë e tij ligjore, problematikën aktuale dhe nevojën e biznesit, si dhe kërkesat e grupeve të interesit dhe përdoruesve fundorë. Elementët e mëposhtëm janë identifikuar me synim projektimin e vizionit të integruar të ASIG-ut:

- ✓ Funksionet e shumta të ASIG-ut si pjesë e infrastrukturës së gjeoinformacionit: politikëbërës, koordinues, manaxhues, propozues dhe rekomandues. Si rezultat, është synuar hartimi i një vizioni multi-dimensional që do të reflektojë nevojën e përdoruesve fundorë, ofruesve të GI, ASIG-ut në vetvete, dhe që përmbush kërkesat ligjore dhe të Direktivës INSPIRE.
- ✓ Diferenca midis ofertës dhe kërkesës që udhëheq deri në materializimin e Qëllimit Thelbësor për një produkt të plotë dhe cilësor, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, mund të zgjidhet vetëm përmes koordinimit dhe ndërveprimit të të gjithë aktorëve pjesë të gjeoinformacionit, bashkimit të përpjekjeve dhe të punës së tyre, proceseve, infrastrukturës, përmes ciklit të plotë, si pjesë e së tërës, në një pjesë të vetme, nga një perspektivë e integruar në kohë, hapësirë, procese dhe teknologji.
- ✓ ASIG-u duhet të përmbushë qëllimin e tij me synim që të sigurojë gjenerimin, zhvillimin, furnizimin me informacion dhe njohuri gjeohapësinore, në mënyrë të plotë, të integruar, të standardizuar dhe lehtësisht të aksesueshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë në biznesin e gjeoinformacionit, për të gjithë territorin e Shqipërisë, sipas standardeve Europiane dhe Direktivës INSPIRE.


Ajo çfarë ASIG-u shikon = “përfytyron”, si zgjidhje për të gjithë problemet dhe pyetjet, të cilat do të garantojnë realizimin e qëllimit final, është lidhja e të gjithë elementëve, të dhënave, informacionit dhe njohurive, burimeve dhe teknologjisë, institucioneve dhe strukturave, proceseve dhe funksioneve, në një **“Sistem Kombëtar të Integruar të Informacionit & Njohurisë Gjeohapësinore”**.

Vizioni në fakt, është një vizion i integruar për të gjithë aktorët në biznesin e informacionit dhe njohurisë gjeohapësinore, sepse pavarësisht këndvështrimit të tyre, ata janë parë si pjesë integrale e vizionit. Për shembull, një përgjegjësi e ZRPP-së është të ofrojë Hartat Kadastrale dhe informacionin mbi pronësinë (që është i plotë, i përditësuar, i saktë, etj.) duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm të shtetit dhe të qytetarëve të tij. Megjithatë, për ta arritur këtë qëllim, ZRPP-ja duhet të koordinohet dhe të ndërveprojë, për të siguruar inpute dhe ofruar outpute, nga pothuajse të gjithë grupet e interesit, pra praktikisht ZRPP-ja shikon të njëjtin vizion por nga perspektiva e pasurive të paluajtshme.


Vizioni gjithëpërfshirës i ASIG-ut të së ardhmes, është përmbledhur në deklaratën e Vizionit:

“Një Tërësi e Integruar”

Në mënyrë simbolike, kjo deklaratë paraqitet përmes imazhit të mëposhtëm:



Bazuar në qasjen sistem dhe metodologjinë, sipas perspektivës tre dimensionale dhe ‘HD’ është zbërthyer vizioni i ASIG-ut: “Një Sistem Kombëtar i Integruar i Informacionit Gjeohapësinor”. Bazuar në teorinë e sistemeve, çdo sistem zbërthehet në këto elemente:
Sistem = Kufijtë + Organizatat + Inputet + Proceset + Outputet + Outcome-i (rezultati)



Sistemi Kombëtar i Integruar i Informacionit Gjeohapësinor

Elementët e zbërthyer të sistemit kombëtar të gjeoinformacionit, janë përshkruar më poshtë:

Kufijtë e sistemit: Sistemi është kombëtar, kështu që limitet e tij do të jenë:

- ✓ i shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë (28,748 km²);
- ✓ në të gjithë nivelet e administratës (vendore, rajonale, qendrore);
- ✓ për të gjitha kategoritë e informacionit gjeohapësinor.

Organizimi i Sistemit: nënkupton organogramën e tij, që konsiston në:

- ✓ arkitektura e tij që përfshin funksionet e ndryshme që do realizohen, duke i grupuar dhe lidhur funksionalisht;
- ✓ struktura e tij, që është organizimi strukturor i institucioneve, agjencive ose entiteteve të ndryshme publike dhe private, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, varësinë midis tyre ose strukturave të tjera;
- ✓ infrastruktura e koordinimit dhe komunikimit, proceseve të kontrollit dhe manaxhimit të riskut.

Inputet e sistemit: Janë të gjithë burimet e nevojshme që e furnizojnë dhe e bëjnë sistemin operativ. Ato mund të përmbliidhen si më poshtë:

- ✓ Të gjithë tipet e burimeve dhe energjia njerëzore të përdorura për manaxhimin, mbledhjen, procesimin, gjenerimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e informacionit gjeohapësinor dhe njohurive, në të gjithë pikat e sistemit dhe strukturës;
- ✓ Të gjitha burimet financiare dhe qarkulluese, të përdorura për operimin e strukturave, asetëve dhe teknologjive, dhe për sigurimin e inputeve të tjera;
- ✓ Të gjithë asetet fizike dhe teknologjike, rrjete, harduerët, softuerët, të nevojshëm për funksionimin e strukturave dhe gjeoinformacionit;
- ✓ Informacioni dhe njohuritë gjeohapësinore.

Proceset e sistemit:


- ✓ Proceset e ndryshme të punës që realizohen brenda sistemit, në nivel manaxherial dhe operacional, për planifikim, ekzekutim, monitorim dhe kontroll të çdo elementi të sistemit, për të garantuar ofrimin e produktit të gjeoinformacionit;
- ✓ Politikat, rregullat (ligjet, aktet nënligjore, rregullat), etj;
- ✓ Procedurat & Udhëzimet (udhëzuesit, procedurat standarde, instruksionet e punës), etj.

Outputi i sistemit: është Informacioni Gjeohapësinor, konsiston në:

- ✓ **KRGJSH 2010:** Korniza Referuese Gjeodezike e Shqipërisë, e cila do të shërbejë si bazë dhe do të mbështesë të gjithë punimet hartografike, gjeodezike dhe studimet shkencore për hapësirën prej 28,748 km² të Republikës së Shqipërisë.
- ✓ **Ortofoto:** Një Ortofoto, ortoimazh ose ortografi është një fotografim ajror i rregulluar gjeometrikisht ("orthorectified") ku shkalla është uniforme (fotografia ka të njëjtën humbje si hartë). Në dallim të një fotografimi ajror jo korrekt, një ortofoto mund të përdoret për të matur distancat reale, sepse është një prezantim i saktë i sipërfaqes së tokës, pasi është bërë rregullimi ortografik i relievit, shtrembërimet e lenteve dhe pjerrësia e kamerës. Ortografia është shumë e përdorur për krijimin e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS). Softuerët mund të shfaqin ortofoton dhe t'i mundësojnë një operatori të GIS të dixhitalizojë ose të përcaktojë ndarjet e relievit (*line work*), të animojë tekstin ose simbolet gjeografike (të tillë si spitale, shkolla, dhe stacionet e zjarrfikëses).
- ✓ **Harta Bazë:** Janë vizatime (definicione) të formave që kanë attribute të përbashkëta, përmes pikave, vijave (kufijve), ose poligoneve, gjithashtu të quajtura si DEM-Digital Elevation Model (Modeli Dixhital i Lartësive ose prezantimi 3D i sipërfaqes së terrenit të

planetit Tokë). Harta Bazë i ofron përdoruesve përshkrimin e saj. Ju mund të shtoni informacion në Hartën Bazë duke mbivendosur informacione mbi të. Hartat Bazë përmbajnë informacion referencë që mund të na japë një informacion gjeohapësinor të ndryshëm bazuar në atë se çfarë hartografi përpiqet të tregojë. Për shembull, Harta Bazë ka kufijtë ujqorë, kufijtë administrativ dhe të shteteve, emrat e qyteteve, dhe në mënyrë të përgjithësuar lumenjtë. Dikush që është i interesuar për të parë hidrografinë mund të mos interesohet për rrugët kryesore ose kufijtë e Parqeve Kombëtare, kështu që këto shtresa (*layer*) përjashtohen nga Harta Bazë.

- ✓ **Hartat Tematike:** Harta tematike është një tip harte e vizatuar kryesisht për të treguar një temë të veçantë të lidhur me një zonë specifike gjeografike. Këto harta “mund të portretizojnë aspekte fizike, sociale, politike, kulturore, ekonomike, sociologjike, bujqësore, ose të çdo aspekti tjetër të qytetit, shtetit, rajonit, ose kontinentit”.



- ✓ **Gjeoportali Kombëtar:** si mjet për të lehtësuar aksesin ndaj të dhënave. Gjeoportali Kombëtar do të shërbejë si platformë për konsultim, përdorim dhe shkëmbim të informacionit.


Rezultati i sistemit: është Njohuria Gjeohapësinore

Në jetën e përditshme, shpesh i referohemi informacionit Gjeohapësinor si produkti i gjeneruar nga sistemi, por ajo që ne shpesh e harrojmë (duke e lënë jashtë fokusit tonë) është **rezultati** (cili është funksioni dhe përfitimet që sjell ky informacion): që përbën Njohurinë Gjeohapësinore. Pikërisht është kjo njohuri që lejon vendimmarrjen në fusha të ndryshme ku gjeoinformacioni përdoret.

Kjo mund të shpjegohet përmes: piramidës DIKW, e njohur si “Hierarkia e Mençurisë” referuar klasës së modeleve për të prezantuar qëllimin e strukturimit dhe/ose marrëdhënien funksionale midis të dhënave, informacionit, njohurisë dhe mençurisë/urtësisë. *“Zakonisht informacioni përkufizohet në terma të të dhënave, njohuria në terma të informacionit, dhe mençuria/urtësia në terma të njohurisë”.*



- ✓ **Të dhëna:** janë të dhëna konkrete/reale, që ne i mbledhim nga ajo që na rrethon, ose çfarë perceptojmë mbi të (konteksti ku jetojmë). Janë baza materiale, të pastrukturuara dhe të papërpunuara, që shërbejnë si Input për Sistemin.
- ✓ **Informacion:** është procesi i përpunimit të të dhënave në mënyrë të strukturuar dhe të programuar, sipas një logjike të caktuar, për të patur një produkt si Output i sistemit.
- ✓ **Njohuri:** është procesimi i informacionit për t'i dhënë përgjigje pyetjeve dhe për të ditur: “Di-Si?, Di-Kush?, Di-Kur?”
‘Njohuria’ është shpjegim i funksionaliteteteve të produktit ‘informacion’ dhe qëllimeve të informacionit, duke na dhënë rezultatin /përfitimin e një sistemi informacioni.
- ✓ **Mençuri/Urtësi:** është kuptimi dhe shpjegimi i arsyes se përse informacioni ekziston dhe për çfarë përdoret, pra duke iu referuar: “Di-Përse?”. Mençuria është ndikimi që informacioni ka tek grupet e interesit dhe e gjithë shoqëria, dhe që udhëheq drejt Qëllimit Final/Thelbësor.



4.1.3 Misioni


Funksionimi i sistemit varet jo vetëm nga funksionaliteti i elementëve të tij, por roli kryesor qëndron në sigurimin e funksionimit të të gjithë pjesëve të tij, si një e tërë dhe e vetme. Duke qenë se kjo është ekzaktëisht cka ASIG përfiton si vizionin e tij, është pikërisht ky institucion që ka detyrën për të garantuar funksionalitetin si një e tërë dhe e plotë, e sistemit të gjeoinformacionit, në mënyrë të integruar në kohë dhe hapësirë. Asnjë institucion tjetër, që merret me një ose disa tema të caktuara të gjeoinformacionit, nuk është në gjendje të shikojë sistemin si një i tërë, pasi ata janë pjesë të tij dhe realizojnë procese në përputhje me temat specifike dhe në pajtim me funksionet e përcaktuara, duke prodhuar pjesë të produktit të gjeoinformacionit, ndërkohë që roli i ASIG-ut është të bëjë funksional të gjithë sistemin, duke integruar të gjithë elementët e sistemit dhe garantuar një produkt të integruar dhe cilësor.

Sa më sipër, roli kryesor dhe misioni i ASIG-ut është:

“Të Manaxhojë, ngritjen dhe funksionimin e vazhdueshëm të sistemit të Integruar (NSDI), i cili do të garantojë të gjithë Informacionin Gjeohapësinor, në kohë, kosto efektive, dhe sipas cilësisë së kërkuara, përgjatë të gjithë ciklit të jetës së tij”

Deklarata e Misionit të ASIG-ut:

“Të bëjë që gjërat të ndodhin!”



4.2 QËLLIMET & OBJEKTIVAT

Për të përcaktuar Qëllimet & Objektivat në mënyrë reale dhe të plotë, janë marrë në konsideratë disa faktorë kryesorë, përshkruar si më poshtë:

- ✓ Programi i qeverisë & synimet dhe objektivat e sektorit të informacionit në përgjithësi dhe gjeoinformacionit në veçanti, Programi për Shqipërinë Dixhitale 2014-2020, qëllimet dhe objektivat e Qeverisë që duhet të arrihen në vitet e ardhshme, të materializuara në Planin Strategjik për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, me synimin për të mbështetur këto objektiva me gjeoinformacion, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes për zhvillim të qëndrueshëm të vendit;
- ✓ Qëllimi Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare për të qenë pjesë e Bashkimit Europian dhe procesit të bashkimit me shtetet e Bashkimit Europian;
- ✓ Direktiva INSPIRE – e cila është e detyrueshme për shtetet anëtare të Bashkimit Europian për t'a mbajtur këtë direktivë në përmirësim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Nëse Shqipëria do të ketë shansin për të qenë pjesëmarrëse me të drejta të plota në BE, nënkupton që Shqipëria duhet të plotësojë disa detyrime (Direktiva INSPIRE është një prej tyre);
- ✓ Situata ekzistuese, problematikat dhe nevoja e biznesit. Nevojat e gjeoinformacionit dhe realiteti ekzistues i tij, patjetër kërkon përmirësim dhe rritje të cilësisë për të dhënat e gjeoinformacionit, veçanërisht në fushën e pronësisë.

Siç është përshkruar gjatë seksionit të metodologjisë, për përcaktimin e objektivave & qëllimeve është ndjekur principi i pemës së sistemit, pra fillimisht është përcaktuar Qëllimi i Përgjithshëm, dhe më pas është bërë zbërthimi i Qëllimeve & Objektivave të një niveli më sipër në elementë më të detajuar, dhe duke qenë më të detajuar, bëhet më SMART, duke garantuar principin e 100% (pa mbivendosje dhe hapësira të pambuluara).

4.2.1 Qëllimi i Përgjithshëm

Qëllimi i Përgjithshëm (QP) i ASIG-ut është realizimi i vizionit të tij, që përfshin:

“Projektimi, Ndërtimi, Operimi, Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i një sistemi gjeohapësinor funksional e të integruar (NSDI), i cili do të prodhojë informacion dhe njohuri gjeohapësinore, në përputhje me standardet e BE / INSPIRE”

4.2.2 Qëllimet Strategjike

Qëllimet Strategjike (QS) të ASIG-ut parashikojnë materializimin brenda vitit 2020 të sa më poshtë vijon:

Përcakto objektin e punës (çfarë dhe si) ⇒ Ndërto makinerinë ⇒ Programoje atë ⇒ Gjej burime ⇒ Shpërndaj produktet bazë ⇒ Mirëmbaj dhe përmirëso

QS1. Përgatitja e një Strategjie të Integruar për sektorin e gjeoinformacionit dhe një Program Kombëtar për zbatimin e saj, në përputhje me kërkesat për financim të IPA II 2014 – 2020 dhe të gjitha financimet e tjera në dispozicion, bazuar në Biznes Planin Strategjik të ASIG-ut, duke integruar të gjitha nismat pjesore e të vazhdueshme në këtë sektor.


QS2. Ndërtimi i sistemit të integruar të gjeoinformacionit, që nënkupton përcaktimin e funksioneve, organizimin strukturor dhe ndërveprimet midis tyre.

QS3. Programimi i punës dhe proceseve të saj, ngritja dhe zbatimi i politikave, rregullave, procedurave dhe udhëzimeve të punës për elementët bazë të sistemit të gjeoinformacionit.

QS4. Sigurimi i burimeve financiare për të siguruar inputet e sistemit (burime njerëzore, teknologjike dhe kapacitetet operationale), për ngritjen dhe operimin e sistemit të integruar të gjeoinformacionit, dhe realizimin e produkteve bazë të gjeoinformacionit, në të njëjtën linjë me strategjinë dhe Programin Kombëtar të Sektorit (PKS).

QS5. Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve bazë të gjeoinformacionit, duke siguruar akses eficient në gjeoinformacion.

QS6. Garantimi i mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të integruar dhe të gjeoinformacionit.



Qëllimi i Përgjithshëm & Qëllimet Strategjike të ASIG-ut

4.2.3 Objektivat

Për të bërë të mundur realizimin e qëllimeve strategjike të mësipërme, është bërë detajimi i tyre në 18 Objektiva (O) programorë të prekshme dhe SMART, prezantuar si më poshtë:

QS1. Përgatitja e një Strategjie të Integruar për sektorin e gjeoinformacionit dhe një Program Kombëtar për zbatimin e saj, në përputhje me kërkesat për financim të IPA II 2014 – 2020 dhe të gjitha financimet e tjera në dispozicion, bazuar në Biznes Planin Strategjik të ASIG-ut, duke integruar të gjitha nismat pjesore e të vazhdueshme në këtë sektor.

O1.1 Vlerësimi i të gjithë kuadrit strategjik ekzistues të gjeoinformacionit dhe përgatitja e një Dokumenti Strategjik të integruar për të gjithë Sektorin e Gjeoinformacionit.

O1.2 Hartimi i Programit Kombëtar Sektorial (PKS) sipas udhëzimeve të BE-së, si bazë për të siguruar financim nga IPA II 2014 – 2020 dhe të gjitha fondet e tjera në dispozicion (donacione apo shtetërore).

O1.3 Vlerësimi i nevojave dhe përgatitja e një buxheti të integruar për të gjithë sektorin e gjeoinformacionit, bazuar në kriteret dhe prioritetet e përcaktuara për mbështetje buxhetore.

QS2. Ndërtim i sistemit të integruar të gjeoinformacionit, që nënkupton përcaktimin e funksioneve, organizimin strukturor dhe ndërveprimet midis tyre.

O2.1 Vlerësim FunkSIONAL për të gjithë elementët e sektorit të gjeoinformacionit. Funksionet që duhet të realizohen dhe cili aktor aktualisht është duke i realizuar ato. Propozimi se si funksionet e përbashkëta duhet të ndahen bazuar në logjikën e sistemit dhe praktikës/mënyrës më të mirë për të bërë të mundur realizimin e plotë të tyre (funksioneve) në terma të cilësisë, kostos dhe kohës.

O2.2 Projektimi i organogramës funksionale të sistemit dhe ngritja/riorganizimi i strukturave të aktorëve kryesorë, si dhe përcaktimi i roleve dhe detyrave, duke i dhënë përgjigje përfundimtare dhe të saktë pyetjes “*Kush bën çfarë*” në sektorin e gjeoinformacionit (copat e mëdha të funksioneve dhe strukturave të gjeoinformacionit)

O2.3 Përcaktimi i infrastrukturës dhe vënia në zbatim e mjeteve dhe lidhjeve midis strukturave të ndryshme, koordinimi, vendimmarrja dhe shkëmbimi i informacionit, njohurive dhe optimizmi i burimeve.

- *Si ndërveprojnë me njëri-tjetri pjesë të ndryshme të sistemit? (komunikimi, varësia, shkëmbimi, ndërveprimi)*
- *Si lidhet dhe qarkullon energjia e sistemit, burimet e tij, financat, të dhënat, informacioni, njohuritë, etj.?*
- *Si lidhen dhe komunikojnë strukturat e ndryshme të sistemit?*

QS3. Programimi i punës dhe proceseve të saj, ngritja dhe zbatimi i politikave, rregullave, procedurave dhe udhëzimeve të punës për elementët bazë të sistemit të gjeoinformacionit.

O3.1 Hartimi i një kuadri ligjor të përditësuar e integruar për gjeoinformacionin dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit. Zhvillimi dhe zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që do bënin të mundur ndërveprimin dhe koordinimin ndërmjet strukturave, gjenerimin dhe shpërndarjen në mënyrën më të mirë të gjeoinformacionit tek përdoruesit e tij.

O3.2 Hartimi dhe vënia në zbatim e standardeve të sistemit të gjeoinformacionit.

O3.3 Projektimi dhe zbatimi i Manualit të Procedurave të gjeoinformacionit – që do të përcaktojë në detaje programin se si do të realizohen proceset kryesore të punës, ndërveprimet midis tyre, dhe udhëzimet bazë të punës.

QS4. Sigurimi i burimeve financiare për të siguruar inputet e sistemit (burime njerëzore, teknologjike dhe kapacitetet operacionale), për ngritjen dhe operimin e sistemit të integruar të gjeoinformacionit, dhe realizimin e produkteve bazë të gjeoinformacionit, në të njëjtën linjë me strategjinë dhe Programin Kombëtar të Sektorit (PKS).

O4.1 Hartimi i planit financiar dhe ngritja e strukturës koordinuese (midis aktorëve kryesorë në sektorin e gjeoinformacionit, qeverisë shqiptare dhe donatorëve kryesorë në vend), për të mundësuar financimin dhe prioritizimin sipas buxhetit të integruar.

O4.2 Vlerësimi dhe hartimi i planit të trajnimeve dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në institucionet kryesore të sektorit të gjeoinformacionit.

O4.3 Vlerësimi, standardizimi dhe ndërtimi i infrastrukturës bazë fizike, teknologjike dhe softuerike të sistemit, për të mundësuar operimin e NSDI-së.

QS5. Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve bazë të gjeoinformacionit, duke siguruar akses eficient në gjeoinformacion.

O5.1 Ngritja e Kornizës Referuese Gjeodezike të Shqipërisë (KRGJSH), etj.

O5.2 Përgatitja e Ortofotos, Harta Bazë (përfshirë DEM-Digital Elevation Model), dhe ndërtimi i Gjeoportalit Kombëtar për akses eficient në gjeoinformacion.

O5.3 Koordinimi i punës për përgatitjen e Hartave Tematike sipas temave kryesore të INSPIRE.

QS6. Garantimi i mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të integruar dhe të gjeoinformacionit.

O6.1 Përgatitja e planit për monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm ndaj sistemit dhe gjenerimit të informacionit gjeohapësinor.

O6.2 Përgatitja e planit të mirëmbajtjes si për sistemin dhe për gjeoinformacionin, duke përcaktuar rregullat dhe standardet e mirëmbajtjes.

O6.3 Vlerësimi i risqeve kryesore të sistemit të gjeoinformacionit dhe përgatitja e planit të manaxhimit të risqeve.





Figure: Qëllimet strategjike & objektivat e ASIG-ut

4.3 STRATEGJIA

Strategjia është e rëndësishme sepse burimet në dispozicion për të arritur qëllimet e vendosura janë të limituara. Përgjithësisht strategjia përfshin vendosjen e objektivave, përcaktimin e veprimeve për të arritur qëllimet, dhe mobilizimin e burimeve për të ekzekutuar veprimet. Strategjia tregon se si përfundimet (qëllimet) do të arrihen me anë të mjeteve (burimet). Ekzistenca e strategjisë është e rëndësishme për të drejtuar vendimmarrjen, pasi është e pamundur të vëzhgohet dhe kontrollohet çdo gjë në një organizatë.

Michael Watkins, në një përmbledhje të Harvard Business e përkufizon strategjinë si: "Strategjia e Biznesit është tërësia e principeve udhëheqëse që, kur komunikohen dhe adaptohen në organizatë, gjenerojnë modelin e duhur të vendimmarrjes. Strategjia është se si njerëzit mendojnë që organizata do të marrë vendime dhe shpërndajë burime me synim që të plotësohen objektivat kryesore. Një strategji e mirë tregon qartë rrugën, përbëhet nga një tërësi principesh udhëzuese ose rregulla, që definojnë rrugën/drejtimin që njerëzit në organizatë duhet të ndjekin (çfarë duhet të bëjnë dhe nuk duhet të bëjnë) dhe çfarë duhet të kenë prioritet (dhe nuk duhet të kenë prioritet) për të arritur objektivat".

Si ilustrim, misioni tregon **çfarë** do të arrihet; vlera e rrjetit tregon se me vlerën e **kujt/cilit** do të krijohet; strategjia tregon se **si** do të shpërndahen burimet për të realizuar misionin brenda rrjetit; dhe vizioni & stimujt tregon **përse** njerëzit në organizatë duhet të ndihen të motivuar për të performuar në nivelin më të lartë. Së bashku, Misioni, Rrjeti, Strategjia dhe Vizioni përcaktojnë drejtimin strategjik të një organizate. Ata i japin përgjigje pyetjeve *çfarë*, *kush*, *si*, dhe *përse*, të nevojshme për të ndërlidhur fuqishëm veprimet në një organizatë komplekse.



4.3.1 Principet

Bazuar në sa më sipër, janë përcaktuar principet kryesore që duhet të zbatohen me synim ndërtimin e një strategjie fituese për të realizuar qëllimet dhe misionin e ASIG-ut, duke konsideruar:


- ✓ qëllimet strategjike dhe objektivat e përcaktuara;
- ✓ situatën ekzistuese të sistemit, burimet e tij & produktet e gjeoinformacionit, dhe hendekun midis situatës ekzistuese vs. kërkesës së shoqërisë së GI (rezultuar nga Nevoja e Biznesit);
- ✓ bazuar në pikat e forta dhe të dobta të ASIG-ut dhe strukturave të tjera të gjeoinformacionit;
- ✓ kulturë dhe 'mjedisin' institucional të organizatave brenda sektorit të GI dhe më gjerë.

Këto principe do të shërbejnë si parime udhëheqëse që do të gjenerojnë modelin e duhur të vendimmarrjes. Parimet kryesore janë si vijon:

a) **Orientimi Pozitiv:** Është principi që udhëheq aktivitetet e organizatës drejt qëllimeve dhe së ardhmes, dhe jo drejt problemeve dhe së kaluarës. Ekziston një problem i madh në lidhje me orientimin e aktivitetit të agjencive shtetërore në veçanti dhe më gjerë gjithashtu, pasi janë të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve të tyre dhe jo drejt objektivave dhe realizimit të tyre. Kështu, pavarësisht qëllimit të mirë, rezultojnë të kemi një orientim negativ ndaj së shkuarës, duke u bërë pjesë e problemit dhe jo e zgjidhjes. Problemet dhe zgjidhja e tyre duhet të trajtohen në të tashmen, duke synuar arritjen e objektivave dhe jo zgjidhjen e problemit në vetvete.



b) **Orientimi drejt një pike të vetme:** Një princip i tillë orienton të gjithë energjinë dhe aktivitetin e aktorëve në sektorin e gjeoinformacionit drejt një pike të përbashkët, që është plotësimi i qëllimit thelbësor/të integruar i të gjithë aktorëve: të kontribuojnë për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare, përmes furnizimit me gjeoinformacion dhe njohuri (që është i plotë, i saktë, i strukturuar, i unifikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë shoqërinë), në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të saj.




Sa më sipër, strategjia do të bazohet në këtë princip, zbatimi i të cilit mundëson që edhe në rastin kur dy aktorë janë në drejtime të kundërta, të mos jenë në konflikt me njëri-tjetrin por të jenë në harmoni, duke sjellë vlerë të shtuar për arritjen e qëllimeve.

c) **Gatishmëria:** është një princip i cili bazohet në sigurimin e ndërveprimit midis grupeve të interesit në një sistem të integruar përmes gatishmërisë e dëshirës, dhe jo nëpërmjet forcës së ligjit, akteve ose sanksioneve të ndryshme. Eksperiencat e mëparshme kanë treguar që detyrimet ligjore nuk i kanë bërë aktorët të ndërveprojnë, por ishin stimujt e përbashkët të lindur për shkak të nevojës apo vullnetit, që kanë bërë të mundur realizimin e detyrave dhe funksioneve të tyre. Portali Kombëtar GIS



ose Ortofoto, janë dy shembuj pozitivë që tregojnë se si interesat e përbashkëta mundësojnë ndodhjen e ndërveprimit dhe realizimin e punës (ndërkohë që ligji nuk arriti ta bënte diçka të tillë në vite). Në këtë pikë, qasja sistem në një cikël të mbyllur jep efekte jo vetëm për ndërveprimin e inputeve të sistemit, por edhe të tërhequr interes si rezultat i përfitimeve të përbashkëta. Ky parim e kthen edhe detyrimin ligjor në një mekanizëm rregullator për ndërlidhje dhe ndërveprim. Ky princip e orienton ASIG-un si një forcë drejtuese e sistemit të integruar të gjeoinformacionit, duke vepruar si koordinator i strukturave dhe aktorëve të ndryshëm brenda NSDI-së, për të përshtatur proceset e punës kur është e nevojshme, brenda dhe ndërmjet organizatave.

d) **Agile (shkathësi):** Ky princip lidhet me “ciklin Virtuoz” dhe “Pilotimin”, që udhëheq procesin të bëjë cikle të vogla që japin **produkte** për shkak të orientimit pozitivisht ndaj plotësimit të objektivave, qëllimeve dhe vizionit. Një princip i tillë nuk i referohet pilotimit laboratorik (që nuk harxhon kosto dhe kohë), por i referohet pilotimit duke ndjekur/sipas parimit ‘agile’: pilotimi vet është pjesë e sistemit, i cili pas modifikimeve mund të konsiderohet i mbyllur dhe i realizuar (*ndërto me copa, dorëzo, verifiko, mbliidh përsëri kërkesat, riprojekto* ⇒ *ndërto copën tjetër dhe modifiko copën e mëparshme* ⇒ *fillo ciklin nga fillimi*).



Duke përmbledhur të gjitha principet në një fjali të vetme, përcaktohet Deklarata e Strategjisë:

“Orientimi në drejtimin pozitiv, ndaj qëllimeve të përbashkëta, bazuar në vullnetin dhe gatishmërinë e të gjithë aktorëve, duke prodhuar e dorëzuar produkte të pjesshme por që prezantojnë pjesë të plota të sistemit dhe funksioneve të tij, në mënyrë të vazhdueshme në kohë, në përputhje me prioritet që ata kanë për shoqërinë e gjeoinformacionit”.

4.3.2 Prioritetet

Për të bërë të mundur ‘përkthimin’ e principeve të mësipërme në “Mjete Strategjike Vendimmarrëse” dhe më pas zëbrthimin e strategjisë në aktivitete, duke shpërndarë burimet, duke konsideruar shtrirjen e saj në kohë dhe territor, është e rëndësishme të vlerësohen dhe përcaktohen prioritetet në lidhje me 18 objektivat programore të prezantuar më sipër. Vlerësimi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe duke konsideruara të gjitha principet e strategjisë. Kriteret për vlerësimin e prioritetëve (*që mund të shërbejë si model vlerësimi për çdo prioritet në të ardhmen, si dhe për prioritizimin e projekteve dhe buxheteve*), janë si më poshtë:

a) Vlerësimi i outputit të kërkuar & punës që nevojitet për realizimin e tij

- Volumi i punës që nevojitet për realizimin e objektivit;
- Shkalla e vështirësisë së proceseve të punës për realizimin e objektivit;
- Kompleksiteti dhe ndërvarësia me proceset për realizimin e objektivave të tjerë.

b) Vlerësimi i outcome-it (*rezultati*), përfitueshmërisë dhe impaktit që ka objektivi përkatës vs. shoqërisë së gjeoinformacionit

- Përfitueshmëria që jep realizimi i objektivit vs. kërkesave të shoqërisë;
- Rëndësia që ka realizimi i objektivit në raport me problematikën aktuale;
- Rëndësia që ka realizimi i objektivit vs. realizimit të objektivave të tjerë.

c) Vlerësimi i kohës së nevojshme për realizimin e objektivit & impakti që ka në sistem

- Vlerësimi i kohës së nevojshme për realizimin e objektivit;
- Emergjenca për realizimin në kohë të shpejtë në raport me kërkesat e shoqërisë;
- Emergjenca për realizimin në kohë të shpejtë në raport me realizimin e objektivave të tjerë (duke shmangur mundësinë për t’u bërë pengesë për objektivat e tjera).

d) Vlerësimi i nevojës për inpute & pesha financiare e objektivave, dhe disponibiliteti i këtyre inputeve

- Kostoja e inputeve të nevojshme dhe pesha e tyre financiare;
- Disponibiliteti i inputeve të nevojshme;
- Nevoja për inpute nga disa aktorë & në të njëjtëm kohë.

Në tabelën më poshtë është treguar vlerësimi i përgjithshëm i 18 objektivave, sipas çdo kriteri dhe peshës së rëndësisë së tyre:

4 Kriteret e vlerësimit		Vlerësimi i outputeve	Vlerësimi i outcome-it (përfitim)	Vlerësimi i kohës	Vlerësimi i inputeve	Totali
18 Objektivat						
O5.2	Përgatitja e Ortofotos, Hartave Bazë dhe Gjeoportalit Kombëtar	15	13	12	12	52
O2.2	Organigrama funksionale e sistemit	13	10	14	13	50
O1.1	Dokumenti i integruar strategjik për sektorin e GI	15	11	11	12	49
O1.2	Përgatitja e Programit Kombëtar Sektorial	15	13	9	12	49
O4.1	Plan financiar & struktura e koordinimit	15	12	11	9	47
O5.1	KRGJSH- Korniza Referuese Gjeodezike	14	13	12	7	46
O2.1	Vlerësimi funksional	13	9	9	14	45
O4.3	Ndërtimi i infrastrukturës teknologjike & softuerike	7	15	11	9	42
O1.3	Buxhet i integruar për sektorin e GI	13	8	7	12	40
O4.2	Plan trajnimi & zhvillimi për BNj	8	14	11	7	40
O3.2	Standardet e sistemit të GI	7	11	9	9	36
O5.3	Koordinimi & përgatitja e Hartave Tematike	8	12	7	8	35
O6.2	Plan për mirëmbajtjen e sistemit dhe GI	11	6	7	10	34
O2.3	Përcaktimi i infrastrukturës & ndërveprimet të sistemit	8	7	7	12	34
O6.3	Plan për manaxhimin e riskut	10	5	8	9	32
O3.1	Korniza rregulatore e integruar	6	9	4	10	29
O6.1	Plan monitorimi & kontrolli	10	4	5	10	29
O3.3	Manuali i procedurave për sistemin e GI	5	9	5	9	28

4.3.3 Rrugëtimi


Sekuencimi i objektivave është realizuar bazuar në principet e strategjisë dhe prioritetet e përcaktuara. Duke ndjekur këto principe & prioritete, po ashtu duke konsideruar mundësitë për realizimin e tyre dhe kërkesën për të përbushur të gjitha qëllimet strategjike brenda vitit 2020, është realizuar përcaktimi i termave dhe Piketave Kryesore (Milestones) për çdo qëllim strategjik dhe objektivat e tij përkatës, siç është treguar në udhërrëfyesin e mëposhtëm:

Qëllimet strategjike	Objektivat	Piketat kryesore të ASIG-ut	2015	2016	2017	2018	2019	2020
QS1	O1.1	Dokumenti i integruar strategjik për sektorin e GI						
	O1.2	Përgatitja e Programit Kombëtar Sektorial						
	O1.3	Buxhet i integruar për sektorin e GI						
QS2	O2.1	Vlerësimi funksional						
	O2.2	Organigrama funksionale e sistemit						
	O2.3	Përcaktimi i infrastrukturës & ndërveprimit të sistemit						
QS3	O3.1	Korniza rregullatore e integruar						
	O3.2	Standardet e sistemit të GI						
	O3.3	Manuali i procedurave për sistemin e GI						
QS4	O4.1	Plan financiar & struktura e koordinimit						
	O4.2	Plan trajnimi & zhvillimi për BNj						
	O4.3	Ndërtimi i infrastrukturës teknologjike & softuerike						
QS5	O5.1	KRGJSH- Korniza Referuese Gjeodezike						
	O5.2	Përgatitja e Ortofotos, Hartave Bazë dhe Gjeoportalit Kombëtar						
	O5.3	Koordinimi & përgatitja e Hartave Tematike						
QS6	O6.1	Plan monitorimi & kontrolli						
	O6.2	Plan për mirëmbajtjen e sistemit dhe gjeoinformacionit						
	O6.3	Plan për manaxhimin e riskut						

Tabela e Integruar e 6 Qëllimeve Strategjike (QS) & 18 Objektivave (O) vs. afatet kohore

QS1.	Përgatitja e një Strategjie të Integruar për sektorin e gjeoinformacionit dhe një Program Kombëtar për zbatimin e saj, në përputhje me kërkesat për financim të IPA II 2014 – 2020 dhe të gjitha financimet e tjera në dispozicion, bazuar në Biznes Planin Strategjik të ASIG-ut, duke integruar të gjitha nismat pjesore e të vazhdueshme në këtë sektor.	
Nr.	Objektivi Programor	Viti
O1.1	Vlerësimi i të gjithë kuadrit strategjik ekzistues të gjeoinformacionit dhe përgatitja e një Dokumenti Strategjik të integruar për të gjithë Sektorin e Gjeoinformacionit.	2016
O1.2	Hartimi i Programit Kombëtar Sektorial (PKS) sipas udhëzimeve të BE-së, si bazë për të siguruar financim nga IPA II 2014 – 2020 dhe të gjitha fondet e tjera në dispozicion (donacione apo shtetërore).	2016
O1.3	Vlerësimi i nevojave dhe përgatitja e një buxheti të integruar për të gjithë sektorin e gjeoinformacionit, bazuar në kriteret dhe prioritetet e përcaktuara për mbështetje buxhetore.	2016
QS2.	Ndërtimi i sistemit të integruar të gjeoinformacionit, që nënkupton përcaktimin e funksioneve, organizimin strukturor dhe ndërveprimet midis tyre.	
Nr.	Objektivi Programor	Viti
O2.1	Vlerësim funksional për të gjithë elementët e sektorit të gjeoinformacionit. Funksionet që duhet të realizohen dhe cili aktor aktualisht është duke i realizuar ato. Propozimi se si funksionet e përbashkëta duhet të ndahen bazuar në logjikën e sistemit dhe praktikës/mënyrës më të mirë për të bërë të mundur realizimin e plotë të tyre (funksioneve) në terma të cilësisë, kostos dhe kohës.	2016
O2.2	Projektimi i organogramës funksionale të sistemit dhe ngritja/riorganizimi i strukturave të aktorëve kryesorë, si dhe përcaktimi i roleve dhe detyrave, duke i dhënë përgjigje përfundimtare dhe të saktë pyetjes “Kush bën çfarë” në sektorin e gjeoinformacionit (copat e mëdha të funksioneve dhe strukturave të gjeoinformacionit)	2017
O2.3	Përcaktimi i infrastrukturës dhe vënia në zbatim e mjeteve dhe lidhjeve midis strukturave të ndryshme, koordinimi, vendimmarrja dhe shkëmbimi i informacionit, njohurive dhe optimizmi i burimeve. - Si ndërveprojnë me njëri-tjetri pjesë të ndryshme të sistemit? (komunikimi, varësia, shkëmbimi, ndërveprimi) - Si lidhet dhe qarkullon energjia e sistemit, burimet e tij, financat, të dhënat, informacioni, njohuritë, etj.? - Si lidhen dhe komunikojnë strukturat e ndryshme të sistemit?	2019
QS3.	Programimi i punës dhe proceseve të saj, ngritja dhe zbatimi i politikave, rregullave, procedurave dhe udhëzimeve të punës për elementët bazë të sistemit të gjeoinformacionit.	
Nr.	Objektivi Programor	Viti
O3.1	Hartimi i një kuadri ligjor të përditësuar e integruar për gjeoinformacionin dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit. Zhvillimi dhe zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që do bënin të mundur ndërveprimin dhe koordinimin ndërmjet strukturave, gjenerimin dhe shpërndarjen në mënyrën më të mirë të gjeoinformacionit tek përdoruesit e tij.	2018
O3.2	Hartimi dhe vënia në zbatim e standardeve të sistemit të gjeoinformacionit.	2019
O3.3	Projektimi dhe zbatimi i Manualit të Procedurave të gjeoinformacionit – që do të përcaktojë në detaje programin se si do të realizohen proceset kryesore të punës, ndërveprimet midis tyre, dhe udhëzimet bazë të punës.	2020
QS4.	Sigurimi i burimeve financiare për të siguruar inputet e sistemit (burime njerëzore, teknologjike dhe kapacitetet operacionale), për ngritjen dhe operimin e sistemit të integruar të gjeoinformacionit, dhe realizimin e produkteve bazë të gjeoinformacionit, në të njëjtën linjë me strategjinë dhe Programin Kombëtar të Sektorit (PKS).	
Nr.	Objektivi Programor	Viti
O4.1	Hartimi i planit financiar dhe ngritja e strukturës koordinuese (midis aktorëve kryesorë në sektorin e gjeoinformacionit, qeverisë shqiptare dhe donatorëve kryesorë në vend), për të mundësuar financimin dhe prioritizimin sipas buxhetit të integruar.	2016
O4.2	Vlerësimi dhe hartimi i planit të trajnimeve dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në institucionet kryesore të sektorit të gjeoinformacionit.	2020
O4.3	Vlerësimi, standardizimi dhe ndërtimi i infrastrukturës bazë fizike, teknologjike dhe softuerike të sistemit, për të mundësuar operimin e NSDI-së.	2020
QS5.	Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve bazë të gjeoinformacionit, duke siguruar akses eficient në gjeoinformacion.	
No.	Objektivi Programor	Viti
O5.1	Ngritja e Kornizës Referuese Gjeodezike të Shqipërisë (KRGJSH), etj.	2018
O5.2	Përgatitja e Ortofotos, Harta Bazë (përfshirë DEM-Digital Elevation Model), dhe ndërtimi i Gjeoportalit Kombëtar për akses eficient në gjeoinformacion.	2017
O5.3	Koordinimi i punës për përgatitjen e Hartave Tematike sipas temave kryesore të INSPIRE.	2020
QS6.	Garantimi i mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të integruar dhe të gjeoinformacionit.	
Nr.	Objektivi Programor	Viti
O6.1	Përgatitja e planit për monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm ndaj sistemit dhe gjenerimit të informacionit gjeohapësinor.	2020
O6.2	Përgatitja e planit të mirëmbajtjes si për sistemin dhe për gjeoinformacionin, duke përcaktuar rregullat dhe standardet e mirëmbajtjes.	2020
O6.3	Vlerësimi i risqeve kryesore të sistemit të gjeoinformacionit dhe përgatitja e planit të manaxhimit të risqeve.	2020

Pjesa e II Plani i Manaxhimit



5. PLANI I MANAXHIMIT

Qëllimi i Planit të Manaxhimit është garantimi i një “udhërrëfyesi” të punës që është për t’u kryer dhe produkteve ose dorëzimeve që janë për t’u realizuar në fund të projektit. Është dokumenti më thelbësor dhe i rëndësishëm pasi është baza mbi të cilën ndërtohet programi i punës, përcaktohet kosto e projektit si edhe të gjitha burimet e nevojshme për realizimin e projektit.

Objekti i punës së këtij dokumenti është përcaktimi i të gjithë punës së nevojshme për realizimin dorëzimeve të projektit dhe të gjitha produkteve përbërëse, si edhe përcaktimi i karakteristikave të tyre fizike dhe funksionale që përbëjnë bazën e objektit të punës.

Ky dokument përmban si më poshtë:

- **Objekti i Projektit (Project Scope)** - që është e gjithë puna e projektit. Objekti i punës përcakton projektet/aktivitetet dhe prioritetet lidhur me to, sekuencimin sipas prioriteteve, përcaktimin e burimeve të nevojshme dhe programin e punës.
- **Objekti i Produktit (Product Scope)** - që është përshkrimi i karakteristikave fizike dhe funksionale të dorëzimeve dhe produkteve.
- **Struktura e Zbërthimit të Punës–SZP (Work Breakdown Structure–WBS) & Përshkrimi i SZP (WBS Description)** – SZP është ndarja e punës së projektit dhe produkteve të tij deri në një nivel i cili të mundëson manaxhimin sa më të mirë të projektit si dhe përshkrimin e aktiviteteve, kohëzgjatjeve dhe burimeve të nevojshme për realizimin e paketave më fundore të SZB.

Plani i Manaxhimit është ndërtuar sipas linjës së Biznes Planit Strategjik dhe përcakton shumë qartë objektin, SZP, projektet dhe aktivitetet për pesë vitet e ardhshme. Plani i Manaxhimit përcakton prioritetet e projekteve me qëllim lidhjen e tyre me vizionin dhe misionin e integruar, si dhe realizimin e qëllimeve dhe objektivave strategjike. Në Planin e Manaxhimit janë vlerësuar të gjithë burimet e nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike, si dhe projektet dhe aktivitetet brenda afateve kohore të vendosura. Bazuar në objektin e përcaktuar në Planin e Manaxhimit, është hartuar edhe programi 5 vjeçar i punës, që përmban produktet (*outputs*) dhe afatet kohore të realizimit të tyre. Bazuar në programin e punës, i cili përmban aktivitetet dhe burimet përkatëse, është hartuar dhe detajuar buxheti pesë vjeçar i ASIG-ut.

Pra, produktet kryesore të këtij dokumenti janë:

- ✓ Plani pesë vjeçar i punës për ASIG-un (*përcakton rolet dhe përgjegjësitë e ASIG-ut, dhe specifikon aktivitetet më të rëndësishme dhe produktet e shërbimit që rrjedhin prej tyre e që duhet të sigurohen nga ASIG-u; dhe përsa është e mundshme duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të tjera publike në përgatitjen dhe ofrimin e GI, shërbimeve të tjera të lidhura me GI, si dhe në kryerjen e punëve dhe shërbimeve të tjera gjeodezike*).
- ✓ Buxheti pesë vjeçar i parashikuar për ASIG-un (*mbështetur në planin real të punës, duke vlerësuar realisht se çfarë ASIG-u mund të arrijë me stafin dhe burimet e veta financiare, përfshirë dhe produktet që mund të kontraktohen nga palët e treta, me kostot e vlerësuara, të ardhurat e vlerësuara/nëse ka, shuma e nevojshme nga buxheti i shtetit, si dhe fondet potenciale nga donatorët*).

Pasi është kuptuar veprimtaria e ASIG-ut dhe e aktorëve të tjerë, me synim përshtatjen në mënyrën më të mirë të mundshme të qëllimeve dhe objektivave, në këtë dokument janë propozuar ndryshimet në kuadrin rregullator dhe proceset/procedurat të lidhura me këto ndryshime. Me qëllim vlerësimit e realizueshmërisë së qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve që ASIG-u do të kryejë,

duhen përcaktuar disa Indikatorë Kyç të Performancës për ASIG-un dhe aktorët e tjerë. Këta indikatorë do të përdoren për të vlerësuar progresin e punës së ASIG-ut.

Plani i Manaxhimit nuk është një dokument i ngurte dhe i pandryshueshëm, përkundrazi është konceptuar si një dokument që do të përditësohet periodikisht në kohë, duke u konsideruar kjo si një përgjegjësi e ASIG. Minimalisht është e domosdoshme që Plani i Manaxhimit të rishikohet çdo vit nga ASIG për ndryshime të mundshme që i përshtaten realitetit dhe zbatueshmërisë së BPS-së, por gjithmonë duke bërë projeksione 5 vjeçare për të ardhmen, së bashku me programin dhe buxhetin përkatës.

6. OBJEKTI I PUNËS SË SISTEMIT TË INTEGRUAR

6.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Deklarata e Objektivit përcakton punën që duhet të realizohet, strukturën e zbrërthimit të saj (SZP), dhe përshkrimin e SZP-së. Duke vendosur kufijtë e objektit, në fakt janë vendosur kufijtë e punës që duhet të realizohet dhe në të njëjtën kohë është përjashtuar çdo aktivitet ose detyrë që nuk është pjesë e objektit të punës që duhet realizuar brenda 5-viteve të ardhshme. Objekti përcakton standardet ose kufijtë kundrejt të cilëve matet progresi dhe vlerësohet suksesi i arritjes së punës, me qëllim realizimin e saj në:

- ✓ kohë;
- ✓ brenda buxhetit;
- ✓ në nivelin më të lartë të cilësisë.

Problematika më e madhe që ne kemi sot, në Shqipëri dhe më gjerë, është se nuk e konceptojmë sistemin në mënyrë të plotë dhe të integruar, ndërkohë që në realitet secili nga funksionet është i nevojshëm që të kryhet në mënyrë që sistemi të funksionojë. Në situatën kur këto funksione realizohen të paplota, ashtu siç nuk duhet dhe në mënyrë të paintegruar, kemi organizma (sisteme) që nuk kanë qëllim në vetvete të prodhojnë produkt, cilësi, dhe standarde, ndaj vetvetiu prodhohet kaos. Aktualisht kemi sisteme të palidhura, si në nivel horizontal ashtu dhe në nivel vertikal midis institucioneve të ndryshme, duke patur si rezultat institucione në nivel operacional që përcaktojnë vizione dhe institucione në nivel drejtues që merren me grumbullim të dhënash. Kjo përbën një lëvizje kaotike që sjell përplasje dhe energji të shkuar dëm.

Sa më sipër, që prej fillimit të punës për hartimin e BPS, sfida ka qenë dilema midis:

- bërjes së një plani që të kishte si pikë referimi "ASIG-un" duke u kufizuar brenda kufijve të organizatës dhe rolit që ajo mendonte brenda biznesit të gjeoinformacionit;
- apo duke e vendosur pikën e referimit tek "Gjeoinformacioni" duke konceptuar gjithë sistemin, e më pas të shihej cili duhet të ishte roli, funksionet dhe volumi i punës që duhet të realizojë ASIG-u brenda këtij sistemi.

Qasja e "izolimit" në hapësirën e gjeoinformacionit është e pamundur që të funksionojë, pasi për ASIG-un do të sillte më shumë energji të shkuar dëm, përplasje më e madhe, ezaurim i vetvetes dhe i të tjerëve dhe një produkt që rregullon diçka por ndërkohë prish diçka tjetër.

Sipas qasjes së përzgjedhur, **pika e referencës është sistemi i gjeoinformacionit**, konceptuar si: e gjithë hapësira e gjeoinformacionit e përbërë nga nivele, brënda çdo niveli janë funksionet dhe brënda çdo funksioni janë elementët e sistemit të lidhur dhe të koordinuar me njëri-tjetrin, dhe të gjithë elementët e sistemit prodhojnë produktin e integruar të gjeoinformacionit. Kjo është realisht ajo që nënkuptohet me: *"një tërësi, e integruar, e gjallë dhe funksionale"*.

Praktikisht ka tejkallim të objektit të punës së konsulencës të kontraktuar për BPS të ASIG-ut, është dalë jashtë objektit të punës të NSDI-së dhe jashtë objektit të punës së Manaxhimit, duke u përpjekur të shihet i gjithë sistemi i Gjeoinformacionit, i cili duhet të udhëhiqet, drejtohet, manaxhohet, ekzekutohet, në mënyrë të pandërprerë, në të gjitha elementet e kësaj "gjithësie", ku çdo copë ka një qëllim dhe funksion të caktuar. Por pavarësisht të qenurit jashtë gjithë objekteve të cituara të punës, është më mirë të shihet e 'gjithë piktura' dhe sa më shumë të jetë e mundur të integrohen dhe koordinohen të gjitha pjesët e saj.

6.2 DEKLARATA E OBJEKTIT

Deklarata e Objektivit (*Scope Statement*) është dokumenti i cili prek dhe përshkruan projektin, objektin e produktit dhe dorëzimet e projektit (të cilët përcaktojnë karakteristikat fizike dhe funksionale të produktit dhe dorëzimeve të projektit). Qëllimi është të garantojë një gjuhë dhe kuptim të përbashkët midis grupeve të interesit.

PËRKUFIZIMI I “VOLUMIT TË PUNËS”: është drejtimi, menaxhimi dhe ekzekutimi i projektimit, zhvillimit të ndërtimit, vënies në operim dhe mirëmbajtjes, i sistemit të integruar të gjeoinformacionit, për të gjithë shoqërinë e gjeoinformacionit (qytetarët, sektori privat e publik), në gjithë territorin e Shqipërisë, në cilësinë sipas standardeve evropiane INSPIRE dhe në mënyrë të vazhdueshme në kohë.

	Volumi i Punës – zbrëthimi i “perkufizimit”	Cilësimi
1	<i>drejtimi, menaxhimi, ekzekutimi</i>	objekti i programit (<i>program scope</i>)
2	<i>i projektimit, zhvillimit të ndërtimit, operimit & mirëmbajtjes</i>	objekti i projektit (<i>project scope</i>)
3	<i>së sistemit të integruar</i>	objekti i punës (<i>scope of work</i>) / outputi
4	<i>të Gjeoinformacionit</i>	objekti i produktit/rezultati (<i>product scope / outcome</i>)
5	<i>për shoqërinë e Gjeoinformacionit</i>	subjekti i punës / sasia
6	<i>në gjithë territorin e Shqipërisë</i>	produkti vs. territorit
7	<i>në cilësinë sipas standardeve evropiane</i>	produkti vs. cilësisë
8	<i>në mënyrë të vazhdueshme</i>	produkti vs. kohës


6.2.1 Gjeoinformacioni (GI) & Cikli i tij i Jetës

Qëllimi fundor i të gjithë aktorëve të sistemit të gjeoinformacionit është **ofrimi i informacionit gjeohapësinor** të përditësuar, në kohë, cilësor, i unifikuar, i standardizuar, lehtësisht i aksesueshëm dhe kosto efektiv. Me GI nënkuptojmë çdo pikë në gjeohapësinor brenda 28,748 km² të territorit të Shqipërisë, referuar sistemit koordinativ KRGJSH. Ndërsa “Informacion” është çdo atribut që i lidhet këtyre pikave, dhe kombinimi i tyre sipas specifikave të përbashkëta jep hartat bazë dhe ato tematike. “Informacioni” ka përcaktorë të ndryshëm që e definojnë në kohë, në territor, në shtresë (*layer*), në format (dixhital, letër), në shkallë rezolucioni dhe formë skematike (*vektor ose raster*). “Të dhënat” me karakteristika të përbashkëta grupohen në tema. Sipas INSPIRE “të dhënat” janë organizuar në 34 tema, ndërkohë që Korniza Referuese Gjeodezike (KRGJSH) është një ‘element’ i sistemit të GI dhe jo “informacion”, dhe KRGJSH ka strukturën, infrastrukturën dhe proceset e saj.

Që të sigurohet gjeoinformacioni i plotë, sipas specifikimeve dhetributeve të kërkuara, janë një sërë procesesh pune që duhet të kryhen, që prej identifikimit të kërkesës për gjeoinformacion deri në momentin e arkivimit të informacionit të rëndësishëm ose fshirjes së atij të padobishëm, duke përbërë **ciklin e jetës së informacionit** sipas proceseve të mëposhtme:

- ✓ **Zbullo (Discover)** - është procesi i vlerësimit të informacionit që duhet të mblidhet dhe specifikimet e tij në kohë, territor, shkallë rezolucioni dhetribute;
- ✓ **Mblidh (Collect)** - është procesi i kapjes së të dhënave përmes metodave të përcaktuara;
- ✓ **Ruaj & Proseso (Store & Process)** - është procesi i ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave duke iu nënshtruar proceseve transformuese e analizuese dhe prodhimit të GI në formatin e kërkuar;

- ✓ **Shpërndaj & Akses** (*Share & Access*) - është procesi i dhënies së aksesit për komunitetin dhe institucionet, në mënyrë që të sigurohet shkëmbimi i tij;
- ✓ **Mirëmbaj** (*Maintain*) - është procesi i nevojshëm i mirëmbajtjes së vazhdueshme në mënyrë që informacioni të plotësojë nevojën për cilësi, dobishmëri dhe të qenit i përditësuar;
- ✓ **Arkivo ose Fshij** (*Archive or Discard*) - është proces i rëndësishëm dhe realizimi kërkon vlerësimin e kërkesave të INSPIRE, ato ligjore dhe të agjencive ose autoriteteve të tjera për të përcaktuar se cili informacion do të ruhet ose fshihet, formati në të cilin do të mbahen për të ofruar siguri në afatgjatë dhe procesi i arkivimit ose fshirjes së tij.



Cikli i jetës së Gjeoinformacionit

6.2.2 Sistemi i GI & Cikli i Jetës së tij

Për të realizuar të gjitha proceset e punës për gjenerimin e GI dhe për të gjitha temat e tij, nevojitet që të kemi një sistem GI në "Operim të Vazhdueshëm" (*Up & Running*), në mënyrë të plotë dhe funksionale. Me "sistem GI" është nënkuptuar: (i) organizimi funksional dhe institucional, (ii) infrastruktura, dhe (iii) proceset që realizojnë transformimin e inputeve në outpute, si dhe që realizojnë ndërveprimin e elementëve të veçantë të sistemit me njëri-tjetrin. Analiza e situatës ekzistuese të sistemit të GI në Shqipëri është e tillë që tregon se, sistemi aktual e ka përmbyllur ciklin e vet të jetës dhe duhet të rifillojë një cikël të ri bazuar në konceptet e INSPIRE. Pjesë e

punës që duhet për të pasur një sistem funksional dhe që operon në mënyrë të vazhdueshme (*Up & Running*), janë **proceset e punës që përbëjnë ciklin e jetës së sistemit të GI**.

Cikli i jetës së sistemit sipas sistemeve inxhinierike shikohet si një sistem që adreson të gjithë fazat e ciklit të tij të ekzistencës duke përfshirë: (i) konceptimin e sistemit, (ii) projektimin dhe zhvillimin, (iii) prodhimin dhe/ose ndërtimin, (iv) operimin, (v) mirëmbajtjen dhe mbështetjen, dhe (vi) ndalimin e aktivitetit dhe shkatërrimin e tij.

- ✓ **Projektimi konceptual:** është faza ku një nevojë e identifikuar ekzaminohet, kërkesat për zgjidhje potenciale identifikohen, zgjidhja potenciale vlerësohet dhe përcaktohen/zhvillohen specifikimet e sistemit. Gjatë kësaj faze të ciklit të jetës së sistemit, projektohen dhe specifikohen nënsistemet të cilat do të kryejnë funksionet e dëshiruara të sistemit. Po ashtu përcaktohen mënyrat e ndërveprimit midis nënsistemeve, si dhe realizohet një test i përgjithshëm dhe vlerësohen nevojat. Hapat kryesorë të kësaj faze janë:
 - Identifikimi i nevojës
 - Analizimi i kërkesave të sistemit
 - Analiza funksionale
 - Sinteza e opsioneve të sistemit
 - Projektimi paraprak i modeleve inxhinierike
 - Zhvillimi i specifikimeve

- ✓ **Projektimi i detajuar dhe zhvillimi:** Kjo fazë përfshin zhvillimin e projektit të detajuar duke e shndërruar punën e projektimit paraprak në një formë të plotë dhe që plotëson të gjitha specifikimet. Kjo punë përfshin specifikimin e ndërfaqësve midis sistemit dhe një analize gjithëpërfshirëse të kërkesave të logjistikës së sistemit, mirëmbajtjes dhe mbështetjes. Projektimi i detajuar dhe faza e zhvillimit, janë përgjegjëse për prodhimin e produktit, specifikimet e procesit dhe materialit, dhe mund të rezultojë në ndryshime të konsiderueshme ndaj specifikimeve të zhvillimit. Hapat kryesorë të fazës së projektimit të detajuar dhe zhvillimit janë:
 - Projekti i detajuar
 - Zhvillimi i modelit inxhinierik dhe prototipit
 - Rishikimi i specifikimeve të zhvillimit
 - Specifikimet e produktit, procesit dhe materialit
 - Rishikim i projektit

- ✓ **Prodhimi dhe ndërtimi:** Gjatë fazës së prodhimit dhe/ose ndërtimit zhvillohet produkti sipas kërkesave të prezantuara gjatë specifikimeve të produktit, procesit dhe materialit të fazës së mëparshme. Gjatë kësaj faze realizohet dhe një vlerësim i sistemit, me qëllim rregullimin e mangësive të sistemit dhe përshtatur sistemin për përmirësim të vazhdueshëm. Hapat kryesorë të fazës së ndërtimit të produktit janë:
 - Prodhimi dhe/ose ndërtimi i komponentëve të sistemit
 - Shpërndarja dhe operimi i sistemit
 - Testimi i operimit të sistemit dhe vlerësimi
 - Vlerësimi i sistemit

- ✓ **Funksionimi dhe mbështetja:** Pasi sistemi vendoset në funksionim, ai përdoret për rolin operacional për të cilin është i destinuar dhe mirëmbahet në mjedisin e tij operacional. Hapat kryesorë të fazës të shfrytëzimit/funksionimit dhe suportit janë:
 - Operimi i sistemit në mjedisin e përdoruesit
 - Manaxhimi i ndryshimit
 - Modifikime të sistemit me qëllim përmirësimi

- ✓ **Ndalimi i aktivitetit dhe shkatërrimi:** Efienca dhe efektiviteti i sistemit duhet të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme për të identifikuar se kur produkti ka plotësuar efiençën maksimale të ciklit të jetës së tij. Vëmendje duhet t'i kushtohet: ekzistencës së vazhdueshme të nevojës operationale, përputhjes midis kërkesave operationale dhe performancës së sistemit, fizibilitetit midis fazës së ndalimit të aktivitetit dhe mirëmbajtjes, dhe disponibilitetit të alternativave të tjera të sistemit.



6.3 STRUKTURA E ZBËRTHIMIT TË PUNËS

Më sipër është përshkruar në mënyrë të detajuar i gjithë objekti i punës i qeverisjes së sistemit të integruar të gjeoinformacionit, sipas niveleve funksionale dhe përgjatë gjithë ciklit të jetës së çdo niveli, për të gjithë elementët e sistemit të integruar. Ky është volumi i duhur i punës që garanton një sistem në operim dhe përmirësim të vazhdueshëm (*Up & Running*), në mënyrë funksionale, të qëndrueshme në kohë dhe që bën të mundur gjenerimin e gjeoinformacionit të plotë, cilësor, në kohë dhe kosto efektiv.

Për të bërë të mundur kuptimin dhe manaxhimin e këtij volumi pune, duhet të bëhet zbërthimi i tij në mënyrë sistematike në copa pune më të vogla, të lidhura me njëra-tjetrën dhe të manaxhueshme, sipas niveleve, fazave, funksioneve dhe proceseve e produkteve në fund të tyre, duke dhënë Strukturën e Zbërthimit të Punës (SZP) të të gjithë sistemit.


Struktura e Zbërthimit të Punës është ndarja hierarkike e: (i) punës së nevojshme për realizimin e projektit, (ii) dorëzimeve të tij, (iii) dhe produkteve të projektit në komponentë më të vegjël dhe të manaxhueshem. Përfitimi i këtij dokumenti është se ofron një vizion të strukturuar të asaj çfarë duhet dorëzuar.

6.3.1 Nivelet e SZP

Çdo nivel i poshtëm i Strukturës së Zbërthimit të Punës përfaqëson një përcaktim më të detajuar të punës së projektit. SZP-ja është ndërtuar në mënyrë të tillë që të garantojë përfshirjen e të gjithë punës së projektit bazuar në principin e 100%.

- **Niveli 0 (ref.A):** përfaqëson të gjithë projektin, që i referohet Sistemit të plotë dhe të Integruar të Gjeoinformacionit;
- **Niveli I:** përfaqëson kategoritë kryesore të punës që duhet kryer në mënyrë që të realizohet projekti ku përfshihen, puna për Drejtimin e Programit, Manaxhimin e Programit, Ngritjen dhe Operimin e Sistemit të Integruar, si edhe gjithë puna e nevojshme për mbështetjen e këtij programi, kontrollin e cilësisë së tij dhe mbrojtjen e kësaj pune;
- **Niveli II:** përfaqëson komponentët kryesorë të kategorive të punës që duhet kryer sipas natyrës;
- **Niveli III:** përmban proceset kryesore të secilës punë sipas fazave/niveleve nëpër të cilat kalojnë secila prej kategorive të punës (të identifikuar dhe të pozicionuara në nivelin II), dhe është i përputhur me objektivat e përcaktuara për ASIG-un;
- **Niveli IV:** përbëhet nga produktet që janë pjesë përbërëse e të gjithë komponentëve të cdo pune, të cilët karakterizojnë dhe detajojnë këto punë. Programi i Punës do të hartohet deri në këtë nivel. Ky nivel do të shërbejë edhe si nyje kontrolli për matjen dhe raportimin e punës së realizuar gjatë projektit nga ana e Manaxherit të Projektit.

Në mënyrë skematike SZP-ja e projektit paraqitet më poshtë:



6.3.2 Përshkrimi i SZP

Përshkrimi i mëposhtëm, i lidhur me SZP-në, shpjegon dhe detajon punën që duhet të ekzekutohet. Bazuar në propozimin e prezantuar, qasja më e përshtatshme për realizimin e plotë të punës për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit është ajo programatike. Kjo implikon që paketat e punës të detajuara në SZP-ë mund të konsiderohen si nënprograme ose projekte me vete, duke pasur parasysh volumin e punës që kërkohet për realizimin e tyre. Një tjetër faktor në përzgjedhjen e përjasjes programatike, është shtrirja në kohë e punës dhe aktivitetëve për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit, kompleksiteti i lartë i punës si dhe numri i madh i burimeve (njerëzore, teknologjike, financiare) që duhet të angazhohen për ngritjen dhe operimin optimal të Sistemi të Gjeoinformacionit. Integrimi i këtyre projekteve në një program të vetëm ofron përfitime që do të ishin të pamundura në rast se do të trajtoheshin si projekte më vete, ndër të cilat përmendim:

- Planifikim efektiv dhe i harmonizuar;
- Alokim eficient i burimeve;
- Monitorim i punës në nivele të ndryshme (drejtues, menaxherial, operacional);
- Koordinim i nismave dhe mbështetjes së ofruar nga donatorët.

Gjithashtu, qasja programatike është në të njëjtën linjë edhe me qasjen sektoriale, të përqafuar dhe të kërkuar fuqishëm nga donatorët kryesorë të qeverisë shqiptare. Zhvendosja nga qasja që bazohet tek zhvillimi i projekteve të veçuara, për tek qasja Sektoriale që harmonizon të gjitha projektet në një fushë të caktuar nën kuadrin e një Programi Kombëtar Sektorial, është rezultat i përvojës së akumuluar përgjatë shumë viteve dhe i aplikimit të ndryshimeve të nevojshme për të rritur efikasitetin në fushën e administrimit publik.

Sipas kësaj qasjeje, puna e nevojshme për sigurimin e të gjithë dorëzimeve të projektit të "Sistemit të Integruar të GI" është zbrërthyer dhe përshkruar në mënyrë të detajuar më poshtë:

A. SISTEMI I INTEGRUAR I GI – është një sistem funksional që punon në mënyre eficiente për të prodhuar gjeoinformacion në përputhje me kërkesat dhe standardet e Direktivës INSPIRE, dhe plotësuar nevojat e klientëve të GI.

A1. DREJTIMI I PROGRAMIT TË NSDI-së

Qëllimi i drejtimit të programit është përcaktimi i orientimit të përgjithshëm të politikave, objektivave, dhe hartimi i strategjive për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit. Drejtimi i programit përfshin:

- **A1.1. Planifikimi Strategjik:** Qëllimi i planifikimit strategjik është të ofrojë të gjithë planifikimin e nevojshëm në nivel strategjik për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit. Pjesë e procesit të planifikimit strategjik është analiza e hollësishme e të gjitha strategjive (të miratuara ose në proces) që lidhen me sektorin e gjeoinformacionit për të vlerësuar impaktin dhe ndërvarësitë mes tyre, hartimi i një plani strategjik në sektorin e gjeoinformacionit si dhe përgatitja e një plani ekzekutimi ose zbatimi që detajon hapat për materializimin e planit strategjik.
- **A1.2. Planifikimi financiar:** Qëllimi i planifikimit financiar është sigurimi i fondeve për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit, vendosjen e objektivave financiare, hartimin e strategjive dhe skemave të financimit që përmbajnë kohën apo afatet e disbursimit, shumën e financuar si dhe burimin e financimit (buxheti i shtetit, donatorë, kredi, etj.).
- **A1.3. Monitorimi dhe Kontrolli:** Qëllimi i monitorimit dhe kontrollit në nivelin drejtues është të sigurojë që, projektet për ndërtimin dhe operimin e sistemit të Gjeoinformacionit, po i përmbahen objektivave dhe prioriteteve strategjike dhe financiare, si dhe po realizohen brenda afateve të kërkuara, pra me efektivitet dhe efikasitet maksimale.

A2. MANAXHIMI I PROGRAMIT TË NSDI-së

Qëllimi i menaxhimit të programit është realizimi i të gjithë nënprogrameve dhe projekteve për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit brenda kostove të përcaktuara, me cilësitë dhe atributet e kërkuara (*product scope*) dhe brenda afatit të parashikuar. Manaxhimi i Programit përfshin:

- **A2.1 Planifikimin:** Qëllimi i planifikimit në nivel manaxherial është të ofrojë të gjithë produktet dhe dorëzimet kryesore të manaxhimit, të nevojshme për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit. Në procesin e planifikimit manaxherial përfshihen hartimi i planit të manaxhimit, programit kombëtar për sektorin e gjeoinformacionit dhe buxhetit të sektorit.
- **A2.2 Monitorimi dhe Kontrolli:** Qëllimi i monitorimit dhe kontrollit në nivelin manaxherial është të mundësojë manaxhimin e kohës së shpenzuar për aktivitetet specifike, të menaxhojë kostot e përcaktuara në mënyrë që të mos ketë varianca të paparashikuara si dhe të menaxhojë çdo ndryshim të nevojshëm në objektin e punës (*scope of work*) dhe në planet bazë të miratuara për zhvillimin e punës (*baselines*).
- **A2.3 Shpërndarja e Përfitimeve:** Qëllimi i kësaj pakete pune është performanca e të gjithë proceseve dhe procedurave të lidhura me produktet/dorëzimet e manaxhimit të programit, me synim ngritjen dhe operimin e sistemit të GI. Sipas kësaj perspektive, është e nevojshme matja e performacës përmes disa Indikatorëve Kryesorë të Performancës, si dhe matja e nivelit të kënaqësisë të klientëve fundorë nga produkti i shpërndarë i GI. Së fundmi, po ashtu është e nevojshme përgatitja e planit të mbylljes (*hand-over*) për të realizuar aktivitetet e mbylljes.

A3. ZHVILLIMI I NSDI-së

Zhvillimi i NSDI-së ka si qëllim kryerjen e të gjithë punës së nevojshme për projektimin-ndërtimin-operimin-mirëmbajtjen e Sistemit të Gjeoinformacionit si dhe gjithë punën me karakter manaxherial që do të mundësojë realizimin e kësaj pune brenda objektit të punës, kostos dhe kohës së kërkuar. Zhvillimi i NSDI-së përfshin:

- **A3.1. Menaxhimi i Zhvillimit të NSDI-së:** Qëllimi i kësaj pakete pune është të mundësojë realizimin e punës për projektim-ndërtim-operim-mirëmbajtje në mënyrë efektive dhe efçente, brenda objektit të punës, duke iu përmbytur buxhetit të përcaktuar dhe në kohën e parashikuar për përfundimin e punës për secilën nga këto faza.
- **A3.2. Projektimi i Sistemit:** Qëllimi i projektimit është konceptimi i sistemit të gjeoinformacionit dhe i arkitekturës së tij në mënyrë të tillë që të përmbushë të gjitha kërkesat e klientëve fundorë, të zotërojë cilësitë dhe karakteristikat e paracaktuara (*product scope*), duke garantuar njëkohësisht përputhshmërinë e tij me vizionin dhe misionin e përcaktuar në biznes planin strategjik të ASIG-ut. Projektimi i sistemit përfshin punën për organizimin funksional dhe institucional të strukturave që përbëjnë sistemin, për hartimin e proceseve që do të zhvillohen brenda sistemit dhe projektimin (vlerësimin) e burimeve të nevojshme për sistemin. Gjithashtu, pjesë e projektimit të sistemit është projektimi i infrastrukturës, pra përcaktimi i cilësive, karakteristikave, teknologjisë elektronike dhe softuerike nga e cila do të përbëhet infrastruktura e sistemit. Puna për dizejimin e infrastrukturës do të përfshijë projektimin e Kornizës Referuese Gjeodezike (KRGJSH), GIS-it Kombëtar dhe Lokal, Rrjetit egov., Shërbimet Web Map dhe Gjeoportalit Kombëtar. Proceset e punës për Projektimin e Sistemit janë:
 - ✓ **A3.2.1. Organizimi Funksional:** Përfshin të gjitha proceset e punës për projektimin e funksioneve dhe kompetencave që strukturat do të kenë dhe do të realizojnë brenda sistemit të gjeoinformacionit.

- ✓ **A3.2.2. Organizimi Institucional:** Përfshin të gjitha proceset e punës për projektimin e strukturës së sistemit dhe rolit që çdo institucion do të ketë në sistem përgjatë ndërveprimit dhe koordinimit me institucionet e tjera.
 - ✓ **A3.2.2. Hartimi i Proceseve:** Përfshin të gjithë punën e nevojshme apo aktivitetet që duhen kryer për identifikimin, projektimin dhe kolaudimin e proceseve që do të zhvillohen brenda sistemit.
 - ✓ **A3.2.4. Vlerësimi i Burimeve:** Kjo paketë përfshin të gjithë punën e nevojshme për identifikimin e burimeve që nevojiten për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit, për përcaktimin e karakteristikave dhe cilësive që duhet të kenë si dhe të volumit të burimeve të nevojshme.
 - ✓ **A3.2.5. Infrastruktura:** Qëllimi i projektimit të infrastrukturës është përcaktimi i cilësive, karakteristikave, teknologjisë elektronike dhe softuerike nga e cila do të përbëhet infrastruktura e sistemit. Puna për projektimin e infrastrukturës do të përfshijë projektimin e KRGJSH-së, Shërbimet Web Map dhe Gjeoportalit Kombëtar.
- **A3.3. NDËRTIMI I NSDI-së:** Qëllimi i ndërtimit të NSDI-së është ndërtimi i sistemit me të gjitha komponentët dhe produktet e përcaktuara gjatë projektimit të sistemit. Proceset kryesore për ndërtimin e NSDI-së janë si më poshtë:
 - ✓ **A3.3.1. Ndërtimi i Kornizës Rregullatore:** Qëllimi i kornizës rregulluese është garantimi i bazës së nevojshme juridike (ligjore dhe nënligjore) për funksionimin e sistemit, përmes përcaktimit të fushës së shtrirjes së sistemit, parimeve të funksionimit, kompetencave dhe të drejtave të strukturave përbërëse, në përputhje me çfarë është miratuar gjatë projektimit të sistemit.
 - ✓ **A3.3.2. Ndërtimi i Kornizës Institucionale:** Kjo paketë pune përfshin të gjitha proceset që i kushtohen ndryshimeve dhe modifikimeve të strukturave dhe institucioneve që do të përbëjnë sistemin e gjeoinformacionit dhe rolit që secili prej tyre do të ketë në kuadër të ndërveprimit brenda sistemit, për të lehtësuar dhe mundësuar përmbushjen me sukses të objektivave.
 - ✓ **A3.3.3. Hartimi i Manualit të Procedurave:** Qëllimi i kësaj pakete pune është të ofrojë një dokument përmbledhës dhe të integruar që të garantojë përkufizime të sakta dhe të qarta të të gjitha procedurave mbi funksionimin e sistemit, mbi ndërvarësinë dhe ndërveprimin e strukturave, mbi mënyrën e operimit të sistemit. Manuali i procedurave do të shërbejë për strukturat e sistemit, për përdoruesit përfundimtarë të gjeoinformacionit dhe për të gjithë aktorët e tjerë që kanë një interes sado minimal në fushën e gjeoinformacionit.
 - ✓ **A3.3.4. Ngritja e Kapaciteteve:** Qëllimi i ngritjes së kapaciteteve është të mundësojë funksionimin eficient të sistemit përmes garantimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore, që zotërojnë kompetencat dhe aftësitë e duhura për operimin e sistemit dhe që janë vazhdimisht të azhurnuar me zhvillimet më të fundit në fushën e gjeoinformacionit.
 - ✓ **A3.3.5. Ndërtimi i Infrastrukturës së Sistemit:** Përfshin të gjithë punën e nevojshme për ngritjen e infrastrukturës së sistemit (KRGJSH-së, GIS-it Kombëtar dhe Lokal, Rrjetit egov., Shërbimet Web Map dhe Gjeoportali Kombëtar) në përputhje me specifikimet dhe karakteristikat e miratuara gjatë fazës së projektimit të infrastrukturës.
 - **A3.4 Gjeoinformacioni:** Qëllimi i kësaj pakete pune është të garantojë gjenerimin dhe shpërndarjen e gjeoinformacionit të azhurnuar në mënyrë të pandërprerë për përdoruesit fundorë, sipas standardeve dhe specifikimeve të përgatitura gjatë projektimit, pra sipas përcaktimit të attributeve dhe kërkesave që gjeoinformacioni duhet të përmbushë. Proceset që lidhen me ofrimin e gjeoinformacionit janë si më poshtë:
 - ✓ **A3.4.1. Standardet e GI:** Ky proces përfshin të gjithë punën e nevojshme për hartimin e standardeve teknike dhe ligjore që duhet të përmbushë informacioni gjeohapësinor, që do të gjenerohet nga Sistemi i Gjeoinformacionit. Standarde të veçanta do të hartohen për secilën nga 34 temat (përfshirë hartën bazë) e përcaktuara në direktivën INSPIRE të Bashkimit Evropian.
 - ✓ **A3.4.2. Prodhimi i GI:** Procesi fillon me Vlerësimin & Inventarizimin (procesi i vlerësimit përfshin analizimin, strukturimin, klasifikimin dhe përmbledhjen e gjeoinformacionit bazuar në nevojat e klientëve fundorë dhe kriteret teknike dhe administrative, dhe duke përfunduar me inventarizimin e GI ekzistues). Proceset prodhuese përfshijnë të gjithë punën e kërkuar për

prodhimin e gjeoinformacionit në përputhje me atributet e parapërcaktuara dhe specififikimet gjatë zhvillimit të standardeve që gjeoinformacioni duhet të plotësojë. Sistemi do të prodhojë gjeoinformacion sipas 34 temave të listuara në direktivën INSPIRE (përfshirë dhe hartën bazë).

- ✓ **A3.4.3. Shpërndarja e GI:** Ky proces përfshin të gjithë punën e nevojshme për dorëzimin e gjeoinformacionit tek përdoruesit fundorë (klientët e sistemit) si dhe krijimin e të gjitha mundësive dhe lehtësive për aksesimin e tij në kohën e kërkuar, në sasinë dhe cilësinë e kërkuar, për secilën nga 34 temat e përcaktuara nga direktiva INSPIRE (përfshirë dhe hartën bazë).
- ✓ **A3.4.4. Përditësimi i GI:** Ky proces përfshin kryerjen e të gjithë punës me karakter operacional për të garantuar përditësimin e vazhdueshëm të gjeoinformacionit, në mënyrë që klientët të furnizohen me informacion të saktë dhe që i përgjigjet realitetit. Për të mundësuar përditësimin e gjeoinformacionit është i domosdoshëm bashkëveprimi dhe komunikimi efektiv mes strukturave të sistemit, çka do të mundësojë që çdo ndryshim të pasqyrohet menjëherë në gjeoinformacionin e ofruar. Sigurisht që azhurnimi do të kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe përsëritëse për të 34 temat e gjeoinformacionit sipas direktivës INSPIRE (përfshirë dhe hartën bazë).
- **A3.5. Mirëmbajtja e NSDI-së:** Qëllimi i të gjithë punëve që i kushtohen mirëmbajtjes së sistemit, është të garantojnë funksionimin e pandërprerë të sistemit në kushte optimale, duke mundësuar mbështetjen e duhur teknike dhe logjistike. Mirëmbajtja e sistemit nënkupton edhe kryerjen e ndërhyrjeve të domosdoshme me karakter modifikues për ta përshtatur sistemin me evoluimin e nevojave dhe kërkesave. Mirëmbajtja e NSDI-së përfshin këto procese:
 - ✓ **A3.5.1. Mirëmbajtja e Kornizës Rregullatore:** Përfshin të gjithë punën e nevojshme për vlerësimin e zbatueshmërisë dhe përshtatshmërisë së kornizës rregulluese (ligjore dhe nënligjore), identifikimin e problematikave, përplasjeve apo papajtueshmërive të lindura gjatë funksionimit të sistemit dhe propozimit të ndërhyrjeve për shmangien e tyre.
 - ✓ **A3.5.2. Mirëmbajtja e Strukturës së Sistemit:** Përfshin të gjithë punën e nevojshme për të mbajtur në gjëndje plotësisht operative dhe optimale strukturën e sistemit, për të identifikuar problematikën dhe shkaqet e tyre në mënyrë që të propozohen masat apo ndryshimet e përshtatshme për siguruar operabilitetin e plotë dhe efektiv të strukturës.
 - ✓ **A3.5.3. Mirëmbajtja e Infrastrukturës së Sistemit:** Mirëmbajtja e infrastrukturës përmbledh të gjitha aktivitetet e nevojshme për të garantuar që infrastruktura e sistemit do të jetë në gjëndje t'i përgjigjet kërkesave për prodhimin e gjeoinformacionit sipas standardeve të përcaktuara. Pjesë e mirëmbajtjes së infrastrukturës është modifikimi dhe përmirësimi i Kornizës Referuese Gjeodezike (KRGJSH), GIS-it Kombëtar dhe Lokal, Rrjetit egov., Shërbimet Web Map dhe Gjeoportali Kombëtar, duke iu përgjigjur evoluimit të kërkesave dhe zhvillimeve teknologjike.
 - ✓ **A3.5.4. Mirëmbajtja e Manualit të Procedurave:** Përfshin punën e nevojshme për Mirëmbajtjen e Manualit të Procedurave. Mirëmbajtja e manualit përfshin identifikimin e problematikave, propozimin e ndryshimeve dhe miratimin e tyre duke angazhuar në proces të gjitha strukturat e sistemit.
 - ✓ **A3.5.5. Mirëmbajtja e Kapacitetit Njerëzor:** Qëllimi i mirëmbajtjes së kapacitetit njerëzor është të mundësojë në çdo çast praninë e burimeve të nevojshme njerëzore që, plotësojnë kriteret profesionale dhe zotërojnë aftësitë e duhura për natyrën e punës që duhet kryer. Pjesë e mirëmbajtjes së kapacitetit njerëzor është evidentimi i nevojave të reja dhe rekrutimi i burimeve njerëzore për të mbuluar këto nevoja, si dhe zëvendësimi i personave që largohen apo transferohen, duke garantuar kështu mosçënimin e veprimtarisë së sistemit (nga mangësitë në burime njerëzore).

A4. Mbështetja e NSDI-së

Qëllimi i mbështetjes është të sigurojë burimet njerëzore, materialet dhe pajisjet teknologjike (pra logjistikën për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit), përmes kryerjes së punëve që lidhen me rekrutimin e burimeve njerëzore dhe prokurimin e mallrave, pajisjeve dhe shërbimeve. Mbështetja (*Suporti*) përfshin këto procese pune:

- **A4.1. Manaxhimi i Mbështetjes së NSDI-së:** Është procesi i menaxhimit të punës operacionale për mbështetjen e projektit me burime njerëzore, teknologji dhe shërbime.

Përfshin aktivitetet e nevojshme për planifikimin e punës së prokurimeve dhe burimeve njerëzore si dhe integrimin e tyre në programin e punës.

- **A4.2 Burimet njerëzore (BNj):** Qëllimi i kësaj pakete punë është garantimi i burimeve të nevojshme njerëzore që zotërojnë kualifikimet dhe aftësitë profesionale për përmbushjen e detyrave që lidhen me ngritjen dhe operimin e Sistemi të Gjeoinformacionit. Kjo paketë pune përfshinë këto procese pune:
 - ✓ **A4.2.1. Plani i BNj:** Përfshin punën për hartimin e planit të burimeve njerëzore që do të përshkruajë në mënyrë të detajuar nevojat për burime njerëzore, si do të ekzekutohet puna për sigurimin e burimeve njerëzore, si do të monitorohet dhe kontrollohet, dhe si do të mbyllet.
 - ✓ **A4.2.2. Përvetësimi i BNj:** Përfshin të gjithë punën e nevojshme për rekrutimin e burimeve njerëzore në kohën e duhur dhe sipas kërkesave të përcaktuara në planin e BNj. Përvetësimi i burimeve njerëzore bëhet në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike që mbulon procedurat për njoftimin e vendeve të lira dhe përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm.
 - ✓ **A4.2.3. Zhvillimi dhe Menaxhimi i BNj:** Përfshin trajnimin e vazhduar të stafit, rritjen e tyre profesionale, promovimin, motivimin dhe hartimin e skemave të shpërblimit.
 - ✓ **A4.2.4. Performanca e BNj dhe Tranzicioni:** Përfshin aktivitetet që shërbejnë për vlerësimin e performancës së burimeve njerëzore përmes metodave dhe teknikave të ndryshme si dhe procedurat mbi vendimmirjen që lidhet me vijimësinë e marrëdhënies së tyre të punës (promovim, largim, transferim, ulje në detyrë).
- **A4.3. Prokurimet:** Qëllimi i prokurimeve është të sigurojnë lëvrimin e mallrave, materialeve dhe pajisjeve në kohën, vendin, cilësinë dhe sasinë e duhur për të mundur ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit. Prokurimet përbëhen nga këto procese:
 - ✓ **A4.3.1. Planifikimi i Prokurimeve:** Është plani që përshkruan me detaje si do të ekzekutohen aktivitetet prokuruese, si do të monitorohen dhe mbyllen këto aktivitete nga personi/at përgjegjës për menaxhimin e mbështetjes.
 - ✓ **A4.3.2. Kryerja e Prokurimeve:** Përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen mbledhjen e ofertave, vlerësimin e ofertave, përzgjedhjen e ofertës më të mirë për prokurimin e mallit, materialit, pajisjes apo shërbimit.
 - ✓ **A4.3.3. Administrimi i Kontratës:** Kjo paketë pune përfshin aktivitetet që lidhen me negociimin, nënshkrimin dhe më pas administrimin/menaxhimin e kontratës (duke kërkuar nga pala tjetër kontraktore përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve).
 - ✓ **A4.3.4. Mbyllja e Kontratave & Performanca:** Përfshihen të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me mbylljen e kontratave në bazë të performancës së furnitorëve dhe nënkontraktorëve duke përdorur si kriter vlerësimi përcaktimet ligjore dhe klauzolat e kontratave.
- **A4.4. Mbështetja Financiare:** Qëllimi i kësaj pakete pune është të sigurojë burimet e nevojshme financiare në kohë, në vendin e duhur, në cilësinë dhe sasinë e duhur, për të mbështetur dhe garantuar ngritjen dhe operimin e sistemit të Gjeoinformacionit. Suporti Financiar përbëhet nga këto procese:
 - ✓ **A4.4.1. Plani Financiar:** Është plani që përshkruan në detaje si do të gjenden dhe sigurohen burimet e nevojshme financiare, përfshirë dhe aktivitetet që duhet të ekzekutohen, si duhet të monitorohen dhe mbyllen këto aktivitete dhe kush është/janë personi/at përgjegjës për menaxhimin e mbështetjes financiare.
 - ✓ **A4.4.2. Ekzekutimi i Planit Financiar:** Përfshin të gjithë aktivitetet ekzekutive për zbatimin e dokumentit të planifikimit të mbështetjes financiare, i cili do të mundësojë ngritjen dhe operimin e Sistemit të GI.

A5. NSDI EXCELLENCE

Qëllimi i Ekselencës është të garantojë ndërveprimin dhe koordinimin e pjesëve të sistemit, kontrollin e funksionimit të tyre dhe Sigurimin e Cilësisë / Kontrollin e Cilësisë së produktit (Ilojet e

ndryshme të gjeoinformacionit), si dhe identifikimin dhe marrjen e masave kundër problematikave dhe risqeve që kërcënojnë sistemin.

- **A5.1. Menaxhimi i Ekselencës së NSDI-së:** Është procesi i menaxhimit të komunikimit, garantimit dhe kontrollit të cilësisë si dhe vlerësimit të risqeve, shoqëruar me hartimin dhe ekzekutimin e planeve të emergjencës për të garantuar zhvillimin e programit në raport me informacionin, cilësinë dhe mbrojtjen e tij.
- **A5.2. Koordinimi & Komunikimi:** Qëllimi i komunikimit dhe koordinimit të sistemit është të mundësojë funksionimin efektiv dhe në harmoni të sistemit, duke garantuar ndërveprimin e strukturave dhe institucioneve dhe shmangur pengesat që ndalojnë apo frenojnë operabilitetin e sistemit. Integrimi dhe Komunikimi përfshin këto procese:
 - ✓ **A5.2.1. Plani i Komunikimit me Aktorët:** Është plani që përshkruan me detaje si do të realizohet komunikimi mes strukturave të sistemit, cila do të jetë frekuenca e komunikimit, metodat dhe mjetet që do të përdoren për të realizuar komunikimin.
 - ✓ **A5.2.2. Struktura e Komunikimit me Aktorët:** përshkruan në detaje strukturën e komunikimit midis aktorëve të ndryshëm në sektorin e GI dhe përtej, duke siguruar komunikimi dhe integrimin eficient.
 - ✓ **A5.2.3. Menaxhimi i Komunikimit me Aktorët:** Përfshin të gjitha aktivitetet e nevojshme për monitorimin dhe kontrollin e komunikimit, duke identifikuar problematikat e mundshme dhe përgatitur masa për tejkalimin e tyre. Pjesë e Menaxhimit të Komunikimit me Aktorët është edhe rishikimi i Planit të Komunikimit duke përmirësuar aspekte të tij që mund të lidhen me mënyrën e shkëmbimit të informacionit apo me teknologjinë e përdorur për përcimin e tij.
- **A5.3. QA/QC:** Është kombinimi i Sigurimit të Cilësisë (*Quality Assurance*), procesi ose tërësia e proceseve të përdorur për të vlerësuar dhe garantuar cilësinë e një produkti dhe Kontrollit të Cilësisë (*Quality Control*), procesi i ofrimit të produkteve dhe shërbimeve në përputhje me kërkesat e klientëve fundorë. Quality Assurance është e orientuar tek procesi dhe përqendrohet në parandalimin e defekteve, ndërsa Quality Control është e orientuar tek produkti dhe përqendrohet në identifikimin e defekteve.
 - ✓ **A5.3.1. Plani i QA/QC:** Është plani që përshkruan me detaje si do të realizohet QA/QC për sistemin në tërësi dhe për produktet e sistemit, si do të monitorohet dhe garantohet cilësia dhe cilat janë strukturat përgjegjëse për kryerjen e QA/QC.
 - ✓ **A5.3.2. Inspektimet:** Përfshin aktivitetet që lidhen me hetimin, përmes ekzaminimit dhe shqyrtimit të imtësishëm të proceseve që zhvillohen brenda sistemit, si dhe të produkteve të sistemit, duke krahasuar rezultatet e inspektimit me kërkesat e specifikuar për të parë nëse ato janë përmbushur.
 - ✓ **A5.3.3. Testimi dhe Kolaudimi:** Është procesi i garantimit që të gjithë komponentët e sistemit janë projektuar, ndërtuar dhe operuar në përputhje me kërkesat. Përfshin zbatimin e një pakete teknikash dhe procedurash për të kontrolluar dhe testuar çdo komponent të sistemit.
- **A5.4. Risku dhe Mbrojtja:** Qëllimi i kësaj pakete pune është identifikimi i problemeve dhe risqeve të mundshme përpara se të ndodhin, në mënyrë që të planifikohen aktivitetet e nevojshme për shmangien apo lehtësimin e tyre. Kjo paketë pune adresohen probleme që mund të rrezikojnë arritjen e objektivave strategjike. Risku dhe mbrojtja përfshin këto procese:
 - ✓ **A5.4.1. Identifikimi i Risqeve & Regjistri i Risqeve:** Përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me përcaktimin e risqeve që mund të pengojnë ose rrezikojnë punën për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit, si dhe hartimi i një regjistri apo databaze ku do të përshkruhet çdo risk i identifikuar.
 - ✓ **A5.4.2. Vlerësimi i Risqeve:** Përfshin punën që lidhet me analizimin e risqeve (caktimit të vlerave sasiore dhe cilësore) në raport me një situatë konkrete. Vlerësimi sasior i riskut kërkon llogaritjen e dy përbërësve, të dëmit që mund të shkaktohet (impaktit) dhe të probabilitetit që risku të materializohet.

- ✓ **A5.4.3. Planet e Reagimit & Emergjencës:** Përfshin të gjithë punën e nevojshme për të hartuar plane të detajuar që përfshijnë opsionet dhe aksionet për të shmangur, reduktuar, transferuar pasojat e dëmshme në rast të materializimit të një risku.
- ✓ **A5.4.4. Monitorimi dhe Kontrolli i Riskut:** Është procesi i monitorimit dhe kontrollit të risqeve të identifikuar, i monitorimit të pasojave jo të drejtëpërdrejta të risqeve dhe i identifikimit të risqeve të reja, duke garantuar ekzekutimin e planeve të reagimit dhe vlerësuar efektivitetin e tyre në reduktimin e riskut.

7. OBJEKTI I PUNËS SË ASIG

7.1 STRUKTURA E ZBËRTHIMIT ORGANIZATIV TË SISTEMIT TË GI

Më sipër është bërë një përcaktim i volumit të punës dhe ndarjes hierarkike të saj në paketa më të vogla dhe të manaxhueshme në formën e një SZP. Ky volum pune realizohet nga të gjithë aktorët që kanë role të ndryshme në Sistemin e Gjeoinformacionit, të përcaktuar në fazën e analizës së situatës ekzistuese. Siç është theksuar dhe më sipër, ka një shpërndarje të punës së mësipërme ndërmjet aktorëve në mënyrë jo funksionale dhe të paintegruar, ndaj pjesë e punës për ngritjen e Sistemit të Gjeoinformacionit është analiza funksionale dhe përcaktimi i fushave të qarta të përgjegjësisë midis institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm në sistemin e gjeoinformacionit. Më pas secili prej tyre lidhet funksionalisht në formë hierarkike, duke na dhënë organogramën e sistemit ose Strukturën e Zbërthimit të Organizatës-SZO (*Organisation Breakdown Structure - OBS*) të sistemit të GI.

Organizimi tipik i aktorëve në sektorin e GI është ai i fragmentizuar, ku për institucionet publike kemi zakonisht një ministri linje për një çështje të caktuar, si planifikimi urban, drejtësia, MIAP, etj.; më pas kemi një ose më shumë institucione që mbulojnë një fushë apo segment të caktuar brenda hapësirës funksionale të Ministrisë si psh. regjistrimi i pasurisë, kthimi i pronave, planifikimi i territorit, adresari, etj; dhe në këto institucione duhet të ketë një sektor të caktuar përgjegjës për Geoinformacionin mbi temën apo çështjen që ata mbulojnë. Në të gjitha këto institucione, vetëm ASIG-u është i tillë, i përcaktuar me ligj që duhet të merret me gjithë sektorin e gjeoinformacionit.

Gjithashtu kemi gjithë sektorin privat që është i pavarur dhe që ka një rol kryesisht në nivelin operacional për prodhimin e gjeoinformacionit apo elementeve të caktuar të infrastrukturës së sistemit, apo në rolin e konsulencës dhe ekspertizës që plotëson për institucionet e ndryshme publike.

Një grup i fuqishëm interesi janë donatorët në këtë fushë, që përsëri janë të organizuar nëpërmjet fushave të veprimit të Ministrive. Zakonisht, çdo donator financon disa projekte të disa institucioneve të ndryshme ose ndosh shpesh që donatorët financojnë pjesë ose faza të ndryshme të të njëjtit projekt brenda një institucioni, të pakoordinuar me njëri-tjetrin. Së fundmi, ka një përpjekje për koordinimin e ndihmës nëpërmjet Grupeve Sektoriale të Punës (*Sektor Working Group*) apo financimi mbi bazë programi dhe jo projektsh të izoluar.


Nevoja që lind vetvetiu në sistemin e gjeoinformacionit për koordinimin e aktorëve të ndryshëm publik e privat, është përpjekur të plotësohet nëpërmjet Bordit të Informacionit Gjeohapsinor (B.I.G.), i cili kryesisht ka rol koordinues, konsultativ dhe vendimmarrës për çështje të caktuara por që vendimet e tij kryesisht kanë fuqi detyruese për ASIG-un sesa për institucionet e tjera. Bordi i Informacionit Gjeohapsinor (B.I.G.) është njësi këshilluese e ASIG-ut dhe Këshilli të Ministrave për të zhvilluar Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Gjeohapsinor - NSDI¹. BIG-u jep mendime teknike lidhur me përputhshmërinë² e të dhënave gjeohapsinore të prodhuara nga autoritetet publike dhe jep opinion mbi standardet shtetërore dhe rregullat uniforme të infrastrukturës së informacionit gjeohapsinor³.

Në mënyrë skematike sistemi aktual i SZO-së paraqitet si në figurën më poshtë:

¹ Neni 10 i Ligjit Nr.72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapsinor në Republikën e Shqipërisë”.

² Neni 12, pika 4 dhe neni 17, pika 4 e Ligjit Nr. 72/2012.

³ Neni 16, pika 1 e Ligjit Nr. 72/2012.



7.2 NIVELET HIERARKIKE TË SISTEMIT

Volumi i punës së sistemit përgjatë gjithë ciklit të jetës së tij - përshkruar më sipër, është vetëm një pjesë e punës që mundëson një sistem që operon në vazhdimësi në mënyrë funksional dhe të plotë, dhe më konkretisht pjesa e ekzekutimit të punës. Për të patur një sistem funksional, nevojitet dhe kryerja e proceseve të ndryshme të punës për manaxhimin, drejtimin dhe udhëheqjen e punës dhe organizimit e të gjithë sistemit. Sa më sipër, nga pikëpamja e funksioneve hierarkike, proceset e punës që duhet të kryhen janë ndarë në 4 nivele si më poshtë:

- ✓ **Niveli Ekzekutiv** - është niveli fundor në piramidën e volumit të punës për Sistemin e Gjeoinformacionit. Në nivelin operacional kryhen të gjitha proceset e punës me karakter teknik dhe profesional. Produkt themelor i punës së nivelit operacional është: Sistemi i Gjeoinformacionit i projektuar, i ndërtuar dhe në gjendje operative që arrin të prodhojë outputet e dëshiruara.
- ✓ **Niveli Manaxherial** - është niveli që bën të mundur realizimin e proceseve të punës nga niveli ekzekutiv, në kohë, me kosto optimale dhe në cilësinë e kërkuar. Kjo realizohet duke analizuar, planifikuar, programuar dhe kontrolluar këtë volum pune në mënyrë të integruar dhe duke garantuar realizimin e objektivave të vendosur. Pra niveli manaxherial siguron kryerjen e të gjitha proceseve e punës për projektimin, ngritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të integruar të gjeoinformacionit. Funksionet e manaxhimit në sistemin e GI duhet të realizohen nga ASIG-u, si institucioni i vetëm që mund të shikojë të gjithë nivelin ekzekutiv të sistemit në mënyrë të plotë dhe të integruar.
- ✓ **Niveli Drejtues** - Për të mundësuar përmbushjen e funksioneve të tij, manaxherit i nevojitet: (i) drejtimi që duhet të ndjekë, pra çfarë duhet të synojë për të realizuar; (ii) objektivat e vendosur që duhet të realizojë; si dhe (iii) strategjinë që duhet të ndjekë gjatë manaxhimit të punës. Të tri këto elemente janë produkte të funksionit të drejtimit që është niveli i tretë në qeverisjen e sistemit të gjeoinformacionit dhe të çdo sistemi në përgjithësi.
Niveli Drejtues kryen një sërë procesesh pune që realizojnë këtë funksion, duke na dhënë si produkt të tij synimet që duhet të realizojmë (pra cilat janë pikat ku duhet të mbërrijmë), cilat janë objektivat në kohë, kosto, punë dhe cilësi që duhet të arrijmë për të realizuar synimet tona për të bërë të mundur realizimin e Vizionit dhe Qëllimit përfundimtar të ekzistencës së sistemit. Gjithashtu, niveli drejtues duhet të sigurojë strategjinë më të mirë që optimizon burimet në dispozicion për arritjen e objektivave dhe qëllimeve.

Drejtimi, pasi analizon se çfarë duhet të bëjë/synojë për të realizuar misionin, vlerëson 'situatën aktuale/ekzistuese' në raport me 'situatën e dëshiruar' sipas Vizionit, dhe bën diferencën midis të dyjave duke përcaktuar se çfarë është e gjitha që duhet të ndiqet dhe realizohet. Niveli Drejtues drejton apo orienton:


- Të gjitha fazat e nivelit manaxherial;
- Të gjithë punën e nevojshme për projektimin, ndërtimin dhe operimin
- Të gjithë elementët e sistemit;
- Të gjitha produktet e gjeoinformacionit.

Funksionet drejtuese në sistemin e gjeoinformacionit duhet të realizohen nga Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP).

- ✓ **Niveli udhëheqës** - Që të mundësohet realizimi i punës dhe produkteve të nivelit Drejtues është e nevojshme të dihet: (i) çfarë synohet të realizohet në fund, (ii) cili është qëllimi fundor dhe (iii) cili është roli i strukturës organizative të sistemit të GI për materializimin e këtij qëllimi. Të treja këto, janë produkte të funksionit udhëheqës që përfshin:

- Përcaktimin e qëllimit;
- Përcaktimin e vizionit;
- Përcaktimin e misionit.

Përcaktimi i qëllimit ka të bëjë me ekzistencën e vetë sistemit të GI dhe strukturën organizative të tij dhe është i lidhur drejtpërdrejt me klientelën/përdoruesit fundorë dhe kërkesat e tyre, të cilët përcaktojnë qëllimin e sistemit të GI nga njëra anë, por në anën tjetër kjo klientelë është edhe përfituese e produktit fundor - që është gjeoinformacioni (i mundësuar dhe ofruar nëpërmjet nivelit ekzekutiv). Në këtë mënyrë, Udhëheqësi bën atë që realisht duhet të bëjë, të vlerësojë dhe ndjejë drejtpërdrejt nevojën dhe kërkesën e njerëzve, duke e kthyer në qëllim të sistemit të GI dhe strukturës së tij organizative, të vlerësojë kapacitetin në nivelin fundor dhe më pas të përcaktojë vizionin se ku duhet të mbërrijë në periudhë afatgjatë. Në raport me nivelin drejtues, Udhëheqësi përcakton edhe rolin dhe misionin që sistemi i GI dhe struktura e tij organizative ka për realizimin e vizionit. Pra kemi, qëllim, vizion, mision, që duhet të përcaktohen nga niveli udhëheqës.



Përmbushja e këtyre funksioneve udhëheqëse plotëson volumin e punës që kryhet përgjatë ciklit jetësor të Sistemit të GI. Funksionet Udhëheqëse në Sistemin e GI kryhen nga BIG-Bordi i Informacionit Gjeohapësinor (por i rikonceptuar në rolin e një Këshilli Kombëtar Sektorial të Gjeoinformacionit) dhe natyrisht edhe nga Këshilli i Ministrave. Në mënyrë të përmbledhur dallimet mes katër niveleve paraqiten në tabelën më poshtë:

NIVELET HIERARKIKE	FUNKSIONET E SISTEMIT	DUHET T'I PËRGJIGJET	PËRGJEGJËSITË	SHËNIME
Niveli Strategjik	Politik	Ku dëshirojmë të shkojmë?	Përcakton: <ul style="list-style-type: none"> Vizionin Misionin Monitoron drejtimin 	Institucioni udhëheqës vendos synimin, vizionin dhe misionin
Niveli Drejtues	Proces	Çfarë rruge do të ndjekim?	Përgjegjës për: <ul style="list-style-type: none"> Qëllimet, Objektivat & Strategjinë Planifikim & Rregullim Monitorim i sistemit 	Jep drejtim përmes qëllimeve & objektivave që duhet të arrihen, dhe strategjinë që duhet ndjekur. Institucioni drejtues përmbush funksionin e tij planifikues dhe rregulator.
Niveli Manaxherial	Procedurë	Si do ta materializojmë atë?	Përgjegjës për: <ul style="list-style-type: none"> Manaxhimin e projektimit Manaxhimin e zbatimit Manaxhimin e operimit 	Niveli manaxherial, përmes nivelit operacional është përgjegjës për materializimin e objektivave në përputhje me dokumentet e planifikimit me qëllim realizimin e vizionit.
Niveli Teknik	Ekzekutim	Si do ta zbatojmë atë?	Përgjegjës për: <ul style="list-style-type: none"> Projektimin e operimit Zbatimin e operimit Punë operationale dhe mirëmbajtje 	Niveli operacional është përgjegjës për realizimin/bërjen e të gjithë punëve specifike gjatë gjithë ciklit.

7.3 MATRICA E CAKTIMIT TË PËRGJEGJËSISË

Për të bërë të mundur përcaktimin e detyrave dhe punës që duhet të realizojë ASIG-u brenda sistemit të Gjeoinformacionit, në mënyrë që më pas të detajohet dhe programohet shtrirja në kohë dhe buxhetet përkatëse, duhet të përcaktohet se cilat do të jenë përgjegjës të ASIG-ut. Për këtë arsye është ndërtuar Matrica e Caktimit të Përgjegjësisë-MCP (*The Responsibility Assignment Matrix – RAM*), që propozohet të përcaktojë rolin e aktorëve kryesorë dhe të ASIG-ut në gjithë sistemin e gjeoinformacionit.

Matrica e caktimit të përgjegjësisë është ndërtuar duke përdorur Strukturën e Zbërthimit të Punës – SZP dhe strukturën e sistemit të Gjeoinformacionit – SZO, për të lidhur dorëzimet dhe/ose aktivitete me burimet. Matrica e caktimit të përgjegjësisë do të sigurojë pamje realiste të burimeve të nevojshme për të materializuar Biznes Planin Strategjik të ASIG-ut. Karakteristika kryesore e saj është qartësia, pasi tregon kush është përgjegjës për çfarë. Së fundmi, duke e lidhur me programin kohor të punës, jep mundësi për të identifikuar kohën se kur çdo dorëzim është i nevojshëm/kërkuar.

Nga pikëpamja e hierarkisë funksionale, aktorët kryesorë mund t'i grupojmë sipas niveleve hierarkike të sistemit të shpjeguar më sipër dhe pasqyruar si në figurën vijuese:



Bazuar në funksionet kryesore që grupimet e mësipërme të aktorëve mbulojnë dhe bazuar në volumin e punës së përcaktuar në SZP që duhet të realizohet për të patur një sistem gjeoinformacioni që operon në vazhdimësi në mënyrë funksionale dhe të plotë, është përgatitur matrica e detajuar e caktimit të përgjegjesisë. Matrica e Përgjegjesisë evidenton çfarë do bëjë ASIG-u brenda SZP-së së gjithë sistemit, ku në bazë të strategjisë dhe deklaratës së misionit është përcaktuar ngritja e ASIG-ut në nivel manaxherial. Por gjithashtu, duke u bazuar edhe në situatën aktuale, problematikat dhe mangësitë në sistem, është e domosdoshme që ASIG të vazhdojë të kryejë edhe të disa funksioneve ekzekutive, drejtuese apo udhëheqës, duke u marrë me prodhim hartash e gjeoinformacioni si dhe me strategjinë e objektivat. Në mënyrë skematike Matrica e përgjegjesisë për grupet kryesore dhe ASIG-un, jepet më poshtë dhe sipas kësaj legjende:

P - Përgjegjës

K - Konsulton

I - të Informohet

M - Miraton

MATRICA E CAKTIMIT TË PËRGJEGJËSISË			Lidhja me Objektivat	KM	B.I.G.	MIAP	ASIG	TË TJERË		
A. SISTEMI I INTEGRUAR I GJEONFORMACIONIT	A1. DREJTIMI I PROGRAMIT TË NSDI	A1.1 PLANIFIKIMI STRATEGJIK	A1.1.1 Analizim i Strategjive të Sektorit	O1.1		P	P	K	I	
			A1.1.2 Plani Strategjik i Sektorit	O1.1	M	P	P	K	I	
			A1.1.3 Plani i Zbatimit	O1.1	M	P	P	K	I	
		A1.2 PLANIFIKIMI FINANCIAR	A1.2.1 Objektivat Financiare	O4.1	I	M	P	K	I	
			A1.2.2 Strategjia e Financimit	O4.1	I	M	P	K	I	
			A1.2.3 Plani i Burimeve & Financimit	O4.1		M	P	K	I	
		A1.3 MONITORIMI & KONTROLLI	A1.3.1 Objektivat e M&K	O6.1		P	P	K	I	
			A1.3.2 Pnortetet e M&K	O6.1		P	P	K	I	
			A1.3.3 M&K i Financimit	O6.1		P	P	K	I	
	A2. MANAXHIMI I PROGRAMIT TË NSDI	A2.1 PLANIFIKIM	A2.1.1 Plani i Manaxhimit	O1.2			M	P	I	
			A2.1.2 Përcaktimi i Sektorit të GI	O1.2	M	M	P	P	K	
			A2.1.3 Programi i Sektorit Kombëtar të GI	O1.2	I	M	P	P	K	
			A2.1.4 Buxheti i Sektorit Kombëtar të GI	O1.3	I	M	P	P	K	
		A2.2 MONITORIMI & KONTROLLI	A2.2.1 Manaxhimi i Kohës	O1.2			I	P	I	
			A2.2.2 Manaxhimi i Kostos	O1.3			I	P	I	
			A2.2.3 Manaxhimi i Ndryshimit	O1.2			I	P	I	
		A2.3 SHPËRNDARJA E PËRFITIMEVE	A2.3.1 Vlerësimi i Performancës	O1.2			I	P		
			A2.3.2 Kënaqësia e Përdoruesve	O1.2			I	P		
			A2.3.3 Aktivitetet e Mbylljes	O1.2			I	P	I	
		A3. ZHVILLIMI I NSDI	A3.1 MANAXHIMI I ZHVILLIMIT TË NSDI	A3.1.1 Organizimi Funkcional	O2.1	M	M	P	K	K
				A3.1.2 Organizimi Institucional	O2.2	M	I	P	K	K
	A3.1.3 Hartimi i Proceseve			O3.3		I	M	P	K	
	A3.1.4 Vlerësimi i Burimeve			O4.2		M	M	P	K	
	A3.2 PROJEKTIMI I SISTEMIT			A3.2.5 Infrastruktura	O4.3	I	M	M	P	P
				A3.2.5.1 KRGJSH & Standardet	O5.1	M	M	I	P	K
				A3.2.5.2 GIS/ Kombëtar & Lokal	O4.3	M	M	I	P	P
				A3.2.5.3 Rrjeti egov.	O4.3	M	M	I	K	P
				A3.2.5.4 Shërbimet Web Map	O4.3	M	M	I	P	K
	A3.2.5.5 Gjeoportali Kombëtar			O4.3	M	M	I	P	K	
	A3.3 NDËRTIMI I NSDI		A3.3.1 Ndërtimi i Kornizës Rregulluese	O3.1	M	I	M	P	P	
			A3.3.2 Ndërtimi i Kornizës Institucionale	O2.2		I	M	K	P	
			A3.3.3 Ndërtimi i Manualit të Procedurave	O3.3		M	I	P	P	
			A3.3.4 Ngritja e Kapaciteteve	O4.2			I	M	P	
			A3.3.5 Ndërtimi i Infrastrukturës së Sistemit	O4.3			I	M	P	
			A3.3.5.1 KRGJSH & Standardet	O5.1			I	P	K	
			A3.3.5.2 GIS/ Kombëtar & Lokal	O4.3			I	M	P	
			A3.3.5.3 Rrjeti egov.	O4.3			I	K	P	
			A3.3.5.4 Shërbimet Web Map	O4.3			I	M	P	
			A3.3.5.5 Gjeoportali Kombëtar	O4.3			I	P	K	
	A3.4 INFORMACIONI GJEOPHAPËSINOR		A3.4.1 Standardet e GI	O3.2	M	M	I	P	K	
			A3.4.2 Prodhimi i GI	O5.3			I	M	P	
			A3.4.2.1 GI i Vlerësuar/Inventari	O5.3		M	I	P	K	
			A3.4.2.2 Prodhimi i Ortofotos	O5.2			I	P	K	
			A3.4.2.3 Prodhimi i Hartave Bazë	O5.2			I	P	K	
			A3.4.2.4 Prodhimi për 32 temat e mbetura	O5.3			I	M	P	
			A3.4.3 Shpërndarja e GI	O5.3			I	M	P	
			A3.4.3.12 Ortofoto	O5.2			I	P	I	
			A3.4.3.34 Harta Bazë	O5.2			I	P	K	
			A3.4.3.1-33 32 temat e mbetura	O5.3			I	A	P	
			A3.4.4 Përditësimi i GI	O5.3			I	A	P	
			A3.4.4.12 Ortofoto	O5.2			I	P	I	
			A3.4.4.34 Imazhi i Hartës Bazë	O5.2			I	P	K	
			A3.4.4.1-33 32 temat e mbetura	O5.3			I	M	P	
			A3.5 MIRËMBAJTJA E NSDI	A3.5.1 Mirëmbajtja e Kornizës Rregulluese	O6.2	M	K	M	P	P
	A3.5.2 Mirëmbajtja e Strukturës së Sistemit			O6.2		I	M	K	P	
	A3.5.3 Mirëmbajtja e Infrastrukturës së Sistemit			O6.2			I	M	P	
	A3.5.4 Mirëmbajtja e Manualit të Procedurave			O6.2			I	M	P	
	A3.5.5 Mirëmbajtja e Kapacitetit Njerëzor			O6.2			I	M	P	
	A4. MBËSHETËTJA E NSDI		A4.1 MANAXHIMI I MBËSHETËTJES SË NSDI	A4.1.1 Plani i BNj	O4.2			I	M	P
				A4.1.2 Sigurimi i BNj	O4.2			I	M	P
				A4.1.3 Zhvillimi & Manaxhimi i BNj	O4.2			I	M	P
				A4.1.4 Performanca e BNj & Tranzicioni	O4.2			I	M	P
			A4.2 BURIMET NJERËZORE	A4.2.1 Plani i Prokurimeve	O4.3			I	M	P
				A4.2.2 Kryerja e Prokurimeve	O4.3			I	M	P
				A4.2.3 Administrimi i Kontratave	O4.3			I	M	P
				A4.2.4 Mbyllja e Kontratave & Performanca	O4.3			I	M	P
			A4.3 PROKURIMET	A4.3.1 Plani Financiar	O4.1			I	M	P
				A4.3.2 Ekzekutimi i Planit Financiar	O4.1			I	M	P
	A4.4 MBËSHETËTJA FINANCIAR		A4.4.1 Plani Financiar	O4.1			I	M	P	
		A4.4.2 Ekzekutimi i Planit Financiar	O4.1			I	M	P		
	A5. EKSELENCA E NSDI	A5.1 MANAXHIMI I EKSELENCËS SË NSDI	A5.1.1 Plani i Komunikimit me Aktorët	O2.3			I	P	K	
			A5.1.2 Struktura e Komunikimit me Aktorët	O2.3			I	P	K	
			A5.1.3 Menaxhimi i Komunikimit me Aktorët	O2.3			I	P	K	
		A5.2 QA/QC	A5.2.1 Plani i QA/QC	O6.1			I	P	K	
			A5.2.2 Inspektimet	O6.1			I	P	K	
			A5.2.3 Testimi & Kolaudimi	O6.1			I	P	K	
		A5.3 RISKU & MBROJTJA	A5.3.1 Identifikimi i Risqeve & Regjistri i Risqeve	O6.3			I	P	K	
			A5.3.2 Vlerësimi i Risqeve	O6.3			I	P	K	
			A5.3.3 Përgjigje ndaj Riskut & Plani i Emergjencës	O6.3			I	P	K	
			A5.3.4 Monitorimi dhe Kontrolli i Riskut	O6.3			I	P	K	


Bazuar në përgjegjësitë e ASIG-ut, siç është nënvizuar në MCP-në e mësipërm të sistemit të GI, është e mundur që qartësisht të përcaktohet Objekti i Punës i ASIG-ut, i cili për më tepër do të detajohet në aktivitete. Në këtë mënyrë është e mundur të përgatitet Programi i Punës dhe Buxheti i ASIG-ut.

7.4 PROPOZIME PËR RISTRUKTURIM (BIG / ASIG)

Në analizën tonë, të katër nivelet e hierarkisë organizative paraqesin problematika. Kjo ka ardhur kryesisht si mungesë e vënies së fokusit tek “puna”, por duke u fokusuar tek institucionet dhe rolet që këto të fundit duhet të luajnë, duke krijuar në këtë mënyrë copëzimin e punës.

Nisur nga sa më sipër, duke qenë se menaxhimi i integruar i informacionit gjeohapësinor përbën një domosdoshmëri të diktuar nga situata aktuale mjaft problematike, si pasojë e fragmentarizmit dhe mungesës së koordinimit institucional, si në nivel politikash e deri në nivel ekzekutues, do të propozojmë një qasje të re drejtimi dhe organizimi institucional për trajtimin e sektorit të gjeoinformacionit. Ky propozim mund të shërbejë si bazë mbi të cilën mund të ngrihet analiza dhe gjithë reforma funksionale dhe strukturore e sektorit të gjeoinformacionit në veçanti, apo më gjerë në gjithë sektorin e informacionit. Propozimi mbështetet në ndarjen e qartë të roleve dhe hierarkisë së funksioneve për ndërtimin e një sistemi të integruar dhe jo duke dhënë zgjidhje parciais, të cilat jo vetëm nuk mundësojnë qëndrueshmëri, por krijojnë konfuzion dhe problematikë të shtuar.

Në mënyrë skematike qasja e re organizative për ndërtimin e një sistemi të integruar të të dhënave gjeohapësinore, do të ishte:



Shkurtimisht, i gjithë propozimi shpjegohet në nënkapitujt e mëposhtëm:

7.4.1 Propozimi për Strukturën e Nivelit Udhëheqës

Gjykohet se është i nevojshëm ndryshimi i rolit të BIG-ut duke u konsideruar tashmë si një Këshill Kombëtar Sektorial në fushën e Gjeoinformacionit, i cili do të duhet të udhëheqë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike zhvillimin dhe monitorimin e reformës në ndërtimin e sistemit dhe administrimin e informacionit gjeohapësinor, në përputhje me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare, duke u mbështetur në prioritetet e Qeverisë. Kjo sjell edhe ndryshimin nga organ këshillues aktualisht, në një organ vendimmarrës në të ardhmen.

Në rolin si Këshill Kombëtar i Gjeoinformacionit, BIG-u do të ketë në përgjegjësi të tij udhëheqjen dhe koordinimin e institucioneve që janë të përfshira në ndërtimin dhe manaxhimin e informacionit gjeohapësinor. Me qëllim realizimin e këtij funksioni, ky i fundit do të duhet të drejtojë procesin e hartimit të Programit Kombëtar Sektorial (sektori i informacionit gjeohapësinor), pjesë integrale e të cilit është dhe një Program Financiar Sektorial.

Për të luajtur këtë rol të rëndësishëm, propozohet që BIG-u të ketë në përbërje të tij përfaqësues të kategorive dhe grupeve të aktorëve të ndryshëm, përkatësisht:

- ✓ Kryeministri ose Zv. Kryeministri;
- ✓ Ministritë/Institucionet përgjegjëse për gjeoinformacionin;
- ✓ Donatorët kryesorë të sektorit të gjeoinformacionit;
- ✓ Sektori privat;
- ✓ Organizata akademike/Universitare dhe Shkencore/Kërkimore;
- ✓ Përfaqësim të Pushtetit Vendor.

Funksionet kryesore të këtij Këshilli do të ishin:

- *Përcaktimi i vizionit të menaxhimit të të dhënave gjeohapësinore;*
- *Përcaktimi/ miratimi i objektivave strategjike (afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata);*
- *Koordinimi ndërinstytucional i të gjithë aktorëve në fushën e Gjeoinformacionit.*

Përsa i përket funksioneve të mësipërme, BIG-u (i rikonceptuar si Këshill) do të kishte rolin e vendimmarrjes për prioritizimin e projekteve në përmbushjen e objektivave, duke udhëhequr procesin e koordinimit nëpërmjet përgatitjes së Programit Kombëtar Sektorial, duke përfshirë dhe Programin Mbështetës Financiar (*Program i kostove të masave të parashikuara në programet politike, të cilat do të mbështeten me financim nga buxheti i shtetit dhe nga partnerët që ofrojnë asistencë*), si dhe monitorimin e përmbushjes së tyre.

Rrjedhimish, BIG-u si Këshill Kombëtar i Sektorit të GI, në hierarkinë vendimmarrëse do të qëndrojë nën Komitetin e Planifikimit Strategjik.

Në mbledhjet e BIG-ut (tashmë në rolin si Këshill Kombëtar i sektorit të GI), propozohet që do të ftohen të marrin pjesë donatorët që janë të lidhur me këtë sektor, sikurse dhe të gjithë aktorët që japin kontribut për sistemin e të dhënave gjeohapësinore.

Që ky ‘organizëm’ të ushtrojë veprimtarinë e tij, natyrisht që ka nevojë të mbështetet nga një sekretariat, që në këtë rast do të vazhdojë të kryhet nga ASIG-u.

Në mënyrë skematike ky nivel hierarkik (Niveli Udhëheqës) do të paraqitet në këtë formë:



7.4.2 Propozimi për Strukturën e Nivelit Drejtues

Aktualisht nga analiza e kryer rezulton se nuk ka një institucion përgjegjës që ka autoritetin për të drejtuar sektorin e të dhënave gjeohapësimore. Për të ushtruar këtë rol, gjykohet se përgjegjësia duhet të centralizohet në një ministri të linjës.

Funksionet kryesore të rolit të drejtuesit do të ishin të karakterit:


- **Strategjik** (politika, strategji, programe, riorganizim, qasje inovatore, etj.);
- **Rregullator** (metodologji, standarde, procedura, etj.);
- **Ekonomik** (financimi i sektorit, alokimet e fondeve, etj.).

Siç u shpjegua dhe më sipër, propozohet që këto funksione të mbulohen nga Ministria përgjegjëse për sistemet e informacionit, por me një strukturë organizimi të brendshëm tërësisht të re (jo më Ministri pa portofol).

Kjo strukturë e dedikuar mund të ishte një njësi e përbërë nga këto tre sektorë:

- **Spektori i Strategjisë së GI;**
- **Spektori Rregullator;**
- **Spektori Ekonomik.**

Në mënyrë skematike ky nivel hierarkik (Niveli Drejtues) do të paraqitet në këtë formë:



7.4.3 Propozimi për Strukturën e Nivelit Manaxherial

Mbështetur në strategjinë, rregullat dhe standardet, si dhe potencialin financiar, të përcaktuar nga struktura që do të mbulojë funksionet drejtuese, njësi që do të jetë përgjegjëse për funksionet menaxhuese do të bëjë të mundur realizimin e objektivave të përcaktuara, konform vizionit të strukturës udhëheqëse vetë, apo nëpërmjet të tjerëve.


Propozimi për ngritjen e kësaj strukture është që kjo e fundit të mundësojë vetëm rolin menaxherial. Por duke qenë se aktualisht funksionet dhe rolet institucionale janë mjaft të fragmentizuara, kjo e fundit për një periudhë tranzitore do të kryejë dhe detyra operacionale që i përkesin nivelit fundor operativ.

Funksionet kryesore të rolit të menxherial do të ishin:

- **Projektues të projektit** (projekton planet për ndërhyrje në sistem - kohë, kosto, cilësi);
- **Projektues të zbatimit** (menaxhon realizueshmërinë e projekteve - kohë, kosto, cilësi);
- **Monitorues të operimit** (menaxhon veprimtarinë operacionale).

Gjykohet se ky rol do të ushtrohet nga ASIG-u.

Duke qënë se niveli operacional (që është dhe niveli bazë ku do të ekzekutohet veprimtaria) do të kërkojë një analizë të thelluar të strukturës së organizimit dhe në të njëjtën kohë të mënyrës së bashkëveprimit me nivelet më të larta të piramidës funksionale (kryesisht me nivelin menaxherial), struktura organizative që do të propozohet për ASIG-un në këtë moment për të luajtur rolin menaxherial, do të ishte si më poshtë:



Organograma e re e propozuar për ASIG

A. Departamenti i Manaxhimit të NSDI

Funksioni i Departamentit të Menaxhimit të NSDI-së është menaxhimi i të gjithë punës së nevojshme për ngritjen dhe operimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor. Menaxhimi i NSDI-së përfshin veprimtarinë operationale me karakter rregullator (akte ligjore dhe nënligjore), projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së Sistemit dhe aspektet që lidhen me Gjeoinformacionin. Pjesë përbërëse e këtij departamenti, do të jenë këto 3 drejtori:

A1. Drejtoria Regullatore: Objekti i punës së kësaj drejtoria është e gjithë veprimtaria që lidhet me aspektet rregullatore/normative për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit të Gjeoinformacionit. Kjo drejtori përfshin 2 sektorë:

- **A1.1 Sektori i Legjislacionit:** Objekti i punës së këtij sektori janë të gjitha aktivitetet që lidhen me vlerësimin dhe analizimin e akteve ligjore në fushën e gjeoinformacionit si dhe të kompetencave ligjore të institucioneve nga të cilat ai përbëhet. Pjesë e veprimtarisë së këtij sektori është edhe përgatitja e propozimeve për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për të shmangur përplasjen e kompetencave duke mundësuar funksionimin efektiv të sistemit. Ky sektor do të jetë përgjegjës edhe për ndjekjen e të gjitha çështjeve me karakter ligjor ndër-institucional dhe me subjektet e tjerë.
- **A1.2 Sektori i Procedurave:** Objekti i punës së këtij sektori është hartimi i të gjitha procedurave me karakter administrativ dhe teknik për proceset e punës që do të zhvillohen brenda sistemit të gjeoinformacionit.

A2. Drejtoria e Infrastrukturës: Objekti i punës së Drejtorisë së Infrastrukturës është e gjitha puna e nevojshme për ngritjen dhe operimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor. Kjo drejtori përfshin 3 sektorë:

- **A2.1 Sektori i KRGJSH-së:** Objekti i punës së sektorit të KRGJSH-së është e gjithë veprimtaria që lidhet me ngritjen, operimin, modifikimin, azhornimin dhe përmirësimin e KRGJSH-së, si një shërbim të domosdoshëm për të gjithë klientët e GjeoInformacionit.
 - **A2.2 Sektori i Gjeoportalit Kombëtar:** Objekti i punës së sektorit të Gjeoportalit janë të gjitha funksionet dhe përgjegjësit që lidhen me ngritjen, operimin, azhornimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të ofruara në të.
 - **A2.3 Sektori i GIS-it:** Objekti i punës së sektorit GIS është e gjithë veprimtaria që i kushtohet ngritjes, operimit, azhornimit, përmirësimit dhe mirëmbajtjes së GIS-it kombëtar.
- A3. Drejtoria e Gjeoinformacionit:** Objekti i punës së drejtorisë së gjeoinformacionit është e gjithë veprimtaria që lidhet me përpilimin e standardeve që Gjeoinformacioni duhet të përmbushë referuar direktivës INSPIRE të BE-së. Pjesë e këtij objekti pune është gjithashtu përgatitja dhe mirëmbajtja e Ortofotos dhe Hartave Bazë. Kjo drejtori përfshin 3 sektorë:
- **A3.1 Sektori i Standardeve:** Objekti i punës së këtij sektori janë të gjithë aktivitetet të domosdoshme për hartimin e standardeve që duhen respektuar në lidhje me përpilimin, përdorimin, shkëmbimin dhe arkivimin e Gjeoinformacionit.
 - **A3.2 Sektori i Ortofotos:** Objekti i punës së këtij sektori është e gjitha veprimtaria e nevojshme për përgatitjen e ortofotos, për mirëmbajtjen, azhornimin dhe shkëmbimin e ortofotove.
 - **A3.3 Sektori i Hartës Bazë:** Objekti i punës së këtij sektori janë kryerja e të gjitha detyrave dhe funksioneve që lidhen me ndërtimin e hartës bazë, përpunimin, mirëmbajtjen, shkëmbimin e informacionit dhe ofrimin e Hartës Bazë ndaj klientëve apo përdoruesve të GI.

B. Departamenti i Menaxhimit të Mbështetjes

Funksioni i Departamentit të Menaxhimit të Mbështetjes është menaxhimi i të gjithë veprimtarisë apo punës së nevojshme me karakter mbështetës për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit. Funksionet mbështetëse përfshijnë sigurimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e tyre, sigurimin e pajisjeve dhe teknologjisë së sistemit përmes prokurimit dhe sigurimin e fondeve për ngritjen dhe operimin e sistemit, duke kryer analizën e kostove dhe hartuar planet e financimit. Ky Departament përbëhet nga 2 drejtori dhe 1 njësi:

- B1. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:** Objekti i punës së kësaj drejtorie është e gjithë puna për menaxhimin e burimeve njerëzore që përfshin rekrutimin, punësimin, shpërblimin, transferimin apo pushimin e nëpunësve. Kjo drejtori përfshin 2 sektorë:
- **B1.1 Sektori i Planifikimit:** Objekti i Sektorit të Planifikimit është planifikimi i nevojës për burime njerëzore për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit, kryerja e procedurave për rekrutimin e burimeve njerëzore, për transferimin, largimin apo pushimin e tyre nga puna.
 - **B1.2 Sektori i Zhvillimit:** Objekti i punës së Sektorit të Zhvillimit është monitorimi dhe vlerësimi i performancës së burimeve njerëzore si dhe trajnimi i vazhduar i tyre në përputhje me nevojat dhe kërkesat e vendit të punës dhe të sistemit në tërësi, për të garantuar azhornimin e vazhdueshëm të sistemit me evoluimin që ndodh në fushën e Gjeoinformacionit në nivel global.

B2. Drejtoria e Manaxhimit të Prokurimeve: Objekti i kësaj drejtorie është e gjitha puna për menaxhimin e prokurimeve të pajisjeve, teknologjisë dhe shërbimeve të nevojshme për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit, në përputhje me programin e punës. Kjo drejtori përfshin 2 sektorë:

- **B2.1 Sektori i Planifikimit:** Objekti i punës së Sektorit të Planifikimit janë të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë me karakter operacional për vlerësimin e nevojave për pajisje, teknologji dhe shërbime për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit si dhe hartimi i planeve të detajuara mbi prokurimet ku ndër të tjera do të përcaktohen edhe afatet dhe specifikimet që duhet të përmbushin mallrat/pajisjet/shërbimet që do të prokurohen.
- **B2.2 Sektori i Koordinimit:** Përderisa volumi i punës për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit do të kryhet nga disa institucione që qëndrojnë në nivele të ndryshme funksionale në raport me njëri-tjetrën, pra është i shpërndarë, dhe ka shtrirje të gjatë kohore, lind nevoja e ngritjes së Sektorit të Koordinimit që do të ketë si objekt të punës së tij koordinimin e të gjithë veprimtarisë prokuruese mes hallkave apo ingranazheve të ndryshme të Sistemit.

B3. Njësia e Manaxhimit Financiar: Objekti i punës së kësaj njësie janë të gjitha aktivitetet që lidhen me planifikimin financiar, pra me kryerjen e analizës financiare dhe planifikimin se si do të sigurohen burimet financiare të nevojshme për ngritjen dhe operimin e Sistemit të Gjeoinformacionit (përfshirë përcaktimin e burimeve të financimit, afateve, mënyrës së alokimit dhe shpërndarjes së fondeve), punën e lidhur me buxhetin e shpenzimet dhe përcaktimin e kostove. Kjo njësi do të mbulojë të gjithë aktivitetet financiare të ASIG-ut, si institucion shtetëror buxhetor.

C. Drejtoria e Manaxhimit të Ekselencës

Funksioni i Drejtorisë së Manaxhimit të Ekselencës përfshin të gjithë punën e nevojshme me natyrë manaxheriale që mundëson realizimin e mbrojtjes nga risqet, të garantimit të cilësisë së proceseve dhe të gjeoinformacionit, si dhe të mundësimin të komunikimit dhe koordinimit efektiv mes strukturave. Kjo drejtori përfshin 3 njësi:

C1. Njësia e Komunikimit dhe Koordinimit

Qëllimi i kësaj njësie është të garantojë koordinimin midis pjesëve të sistemit duke siguruar funksionimin efektiv dhe në harmoni të sistemit, duke garantuar ndërveprimin e strukturave dhe institucioneve dhe shmangur pengesat që ndalojnë apo frenojnë operabilitetin e sistemit. Kjo njësi do të realizojë komunikimin dhe koordinim horizontal (me institucionet përgjegjëse për prodhimin e Gjeoinformacionit dhe me institucionet e jashtme) dhe vertikal (me KM, B.I.G. dhe MIAP), ku ASIG-u do të kryej edhe rolin e tij si sekretariat i BIG-ut. Puna e kësaj njësie konsiston në hartimin dhe ekzekutimin e planit të komunikimit dhe koordinimit.

C2. Njësia e Sigurimit dhe Kontrollit të Cilësisë (QA/QC)

Qëllimi i kësaj njësie është të garantojë cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga sistemi i GI dhe operimin e sistemit në mënyrë funksionale në vazhdimësi. Sigurimi i Cilësisë (Quality Assurance) përfshin tërësinë e proceseve që garantojnë cilësinë e produktit përmes analizimit dhe përmirësimit të proceseve dhe procedurave, ndërsa Kontrolli i Cilësisë (Quality Control) është i orientuar tek produkti dhe përqendrohet në identifikimin e defekteve. Puna e kësaj njësie konsiston në hartimin dhe ekzekutimin e planit të QA/QC-së, i cili përshkruan në detaje mënyrën e realizimit të QA/QC-së, metodat dhe praktikatat që do të përdoren.

C3. Njësia e Riskut & Mbrojtjes

Qëllimi i kësaj njësie është të identifikojë, vlerësojë risqet e mundshme përpara se të ndodhin dhe të planifikojë e ekzekutojë aktivitetet e nevojshme për shmangien apo lehtësimin e tyre. Kjo njësi adreson problemet që mund të rrezikojnë arritjen e objektivave strategjike. Puna e kësaj njësie ndahet në (i) identifikimin dhe analizimin e risqeve që mund të pengojnë ngritjen dhe operimin e sistemit të Gjeoinformacionit dhe (ii) hartimin e planit të detajuar të alternativave për të shmangur, reduktuar apo transferuar pasojat e dëmshme të një risku. Gjithashtu realizohet monitorimi dhe kontrolli i mënyrës së zbatimit dhe efekteve të dhëna si rezultat i masave të ndërmarra për reduktimin e riskut.

7.4.4 Propozimi për Strukturën e Nivelit Operacional

Niveli fundor i strukturës organizative, do të ishte niveli ekzekutues. Ky nivel do të ishte përgjegjës për të gjithë veprimtarinë operationale që do të bënte të mundur funksionimin e Sistemit të Informacionit Gjeohapësinor. Për përcaktimin e strukturave që do të ishin të pozicionuara në këtë nivel, do të nevojitej një analizë e detajuar e organizmit dhe rolit që luajnë aktualisht strukturat aktuale dhe më pas rikonceptimi i skemës organizative institucionale, me qëllim maksimalizimin e efijencës së ndërtimit dhe qarkullimit të informacionit gjeohapësinor.

Funksionet kryesore të rolit manaxherial do të ishin të karakterit:

- **Operues të projektimit** (realizimi konkret i projekteve konform udhëzimeve të menaxhimit)
- **Operues të zbatimit** (realizimi konkret i ndërtimit konform udhëzimeve të menaxhimit)
- **Vënia në funksionim dhe mirëmbajtja** (mirëmbajtja dhe operimi me qëllim arritjen e objektivave të vendosura nga menaxhimi)

Në bazë të analizave që do të kryhen për këtë qëllim, gjithashtu do të realizohet një vlerësim për organizimin strukturor, i cili mund të realizohet nëpërmjet një institucioni privat apo publik, lokal apo kombëtar, gjithëpërfshirës apo tematik, etj.

8. PROGRAMI I PUNËS / PERFORMANCA NË KOHË

Programi kohor i punës është hartuar duke sekuencuar detyrat e strukturës së zbërthimit të punës, për të identifikuar lidhjet logjike midis detyrave. Pasi janë përcaktuar lidhjet/marrëdhëniet, më pas janë vlerësuar burimet e nevojshme dhe janë përcaktuar afatet kohore të çdo detyre për të hartuar analizat e shtrirjes kohore. Programi Kohor i Punës është version specifik i grafikut të projektit i zhvilluar nga analizat e programit kohor të punës, duke pranuar dhe miratuar nga ekipi i manaxhimit të projektit, përcaktimet mbi afatet e fillimit dhe mbarimit.

Programi kohor duhet të pranohet dhe miratohet nga aktorët përkatës (ASIG, MIAP, BIG, etj.). Gjatë monitorimit dhe kontrollit, afatet kohore/datat e programuara do të krahasohen me datën aktuale të fillimit dhe mbarimit për të përcaktuar nëse kanë ndodhur mospërputhje/ndryshime. Programi kohor është një komponent i rëndësishëm i planit të manaxhimit.

8.1 AKTIVITETET

Bazuar në qasjen e vendosur, aktivitetet janë pjesët më të vogla të identifikuara dhe të manaxhueshme të punës së planifikuar në SZP-në e sistemit të gjeoinformacionit. Ato synojnë të realizojnë punën për ngritjen dhe operimin në vazhdimësi të sistemit, duke konvertuar inputet në outputet e dëshiruara, ndërkohë që shfrytëzojnë burimet e alokuara. Në rastin konkret, duke e parë sistemin nga një këndvështrim makro ose nga perspektiva e përgjithshme, aktualisht disa aktivitete mund të konsiderohen si projekte të veçanta. Kjo nënkupton që ato/aktivitetet mund të detajohen më tepër nga profesionistët ose ekspertët të cilët zotërojnë eksperiencën dhe njohuritë në fushën e gjeoinformacionit.

Gjithashtu, aktivitetet janë korniza për të bërë dallimin midis komponentëve të ndryshëm të SZP-së. Detajimi i punës në aktivitete është derivat i përjasjes bazuar në Aktivitete, që ngrihet mbi supozimin që projekti mund të prezantohet si një seri logjike aktiviteteesh të lidhura, prioritzuara dhe sekuencuara, të cilat mund të performohen hap pas hapi ose në mënyrë paralele për të plotësuar qëllimet e projektit. Aktivitetet e ndajnë punën në pjesë të vogla dhe të manaxhueshme, në mënyrë që stafi i projektit të kuptojë veprimet që duhet të ndërmerret.

Varësia dhe marrëdhëniet midis disa aktiviteteve i lidhin ato me njëri-tjetri dhe i fokusojnë ato drejt realizimit të një ose disa qëllimeve strategjike ose objektivave programore. Aktivitetet e përcaktuara janë të matshme, të përshkallëzuara në kohë dhe të destinuara për të prodhuar rezultate. Çështjet të cilat i karakterizojnë ato, janë si më poshtë:

- ✓ Kohëzgjatja
- ✓ Vlerësimi i datës së fillimit dhe mbarimit
- ✓ Lidhja logjike me aktivitetet e tjera
- ✓ Konsumues burimesh
- ✓ Kushtojnë (kanë një kosto të matur në vlerë monetare)

8.2 DIAGRAMA RRJET

Qëllimi i sekuencimit të aktiviteteve është organizimi i tyre sipas një rrjedhe logjike, në mënyrë që të mundësohet realizimi i tyre. Sekuencimi i aktiviteteve ndihmon në përcaktimin e radhës së realizimit të tyre, duke manaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme kohën dhe burimet në dispozicion për realizimin e punës të përcaktuar në SZP (Strukturën e Zbërthimit të Punës). Gjithashtu, sekuencimi i aktiviteteve është një pjesë shumë e rëndësishme e skedulimit. Tipi i aktiviteteve të identifikuara me qëllim realizimin e të gjithë punës lidhur me ngritjen dhe operimin e sistemit të Gjeoinformacionit, paraqitet si më poshtë:

a) **Aktivite paraardhëse dhe pasardhëse**

Aktivitetet paraardhëse duhet të mbarohen përpara se aktivitetet e tjera të fillojnë. Aktivitetet të cilat i ndjekin ato paraardhëse njihen si pasardhëse, ose aktivite të varura. Aktivitetet pasardhëse janë të "lidhura" në zinxhirin e rrjedhës së aktiviteve që nga fillimi deri në përfundimin e punës. Pasi përfundon aktiviteti pasardhës, ai bëhet paraardhës për aktivitetet e tjera, ose ai mund të jetë aktiviteti final i projektit.

b) **Aktivite paralele**


Aktivitetet e njëkohshme ose paralele janë një tip tjetër i aktiviteve të identikuara në SZP. Aktivitetet paralele mund të përfundojnë në të njëjtën kohë, duke shkurtuar kohëzgjatjen e realizimit të të gjithë punës në SZP.

c) **Aktivite fiktive**

Tipi tjetër i aktiviteve pjesë e SZP-së janë aktivitetet fiktive. Aktivitetet fiktive nuk kërkojnë ndonjë burim kur ato ndodhin, pasi është një kohë pritjeje ose "fiktive", midis përfundimit të një aktiviteti dhe fillimit të një aktiviteti tjetër. Megjithëse nuk realizohet asnjë punë, është e rëndësishme që për efekt lehtësie të përfshihen në skedulim, në mënyrë që të mos harrohet që dhe koha "fiktive" ekziston.

d) **Piket kryesore (Milestone)**

Piket kryesore janë tipi tjetër i aktiviteve në skedulim tonë. Ato nuk kërkojnë punë, kohë ose e thënë ndryshe nuk harxhojnë burime. Ato janë pjesë e skedulit për të treguar që një seri aktivitetesh janë përfunduar ose për të prezantuar pikat e progresit. Megjithëse piketat shfaqen përgjatë skedulit, është e rëndësishme të theksojmë që ato nuk prekin rrjedhën e punës. Më poshtë tregohet modeli i Diagramës Rrjet lidhur me paketat standarde të punës:



8.3 VLERËSIMI I BURIMEVE & PROGRAMI


Vlerësimi i kohës së nevojshme është realizuar duke marrë në konsideratë:

- Objektivat e vendosura
- Strukturën aktuale
- Propozimet për ndryshim në organizimin funksional
- Strukturën e re të propozuar


Bazuar në sa më sipër dhe duke detajuar informacionin respektivisht sipas harkut kohor të projektit, është ndërtuar Programi Kohor i Punës, i prezantuar më poshtë:

Programi Kohor i Punës së ASIG-ut:

1	➤ A. Sistemi i Integruar i GI	339 wks	Mon 6/1/15	Fri 11/26/21	
2	➤ A2. Manaxhimi i Programit të NSDI	292 wks	Mon 6/1/15	Fri 1/1/21	
3	➤ A2.1 Planifikimi	48 wks	Mon 6/1/15	Fri 4/29/16	
4	A2.1.1 Plani i Manaxhimit	14 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/4/15	
5	A2.1.2 Përcaktimi i Sektorit Kombëtar të GI	14 wks	Mon 9/7/15	Fri 12/11/15	4
6	A2.1.3 Programi Kombëtar i Sektorit të GI	20 wks	Mon 12/14/15	Fri 4/29/16	5
7	A2.1.4 Buxheti Kombëtar për Sektorin e GI	20 wks	Mon 12/14/15	Fri 4/29/16	655
8	➤ A2.2 Monitorimi & Kontrolli	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	
9	A2.2.1 Manaxhimi i Kohës	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	6
10	A2.2.2 Manaxhimi i Kostos	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	7
11	A2.2.3 Manaxhimi i Ndryshimit	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	955
12	➤ A2.3 Shpërndarja e Përfitimëve	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	
13	A2.3.1 Vlerësimi i Performancës	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	7
14	A2.3.2 Kënaqësia e Përdoruesve	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	1355
15	A2.3.3 Aktivitetet e Mbylljes	244 wks	Mon 5/2/16	Fri 1/1/21	1355
16	➤ A3. Zhvillimi i NSDI	339 wks	Mon 6/1/15	Fri 11/26/21	
17	A3.1 Manaxhimi i Zhvillimit të NSDI	292 wks	Mon 6/1/15	Fri 1/1/21	
18	➤ A3.2 Projektimi i Sistemit	292 wks	Mon 6/1/15	Fri 1/1/21	
19	➤ A3.2.1 Harta e Proceve dhe Ndërveprimi	36 wks	Mon 6/1/15	Fri 2/5/16	
20	Identifikimi i proceseve	8 wks	Mon 6/1/15	Fri 7/24/15	
21	Analizimi i proceseve	18 wks	Mon 7/27/15	Fri 11/27/15	20
22	Rishikimi i proceseve	24 wks	Mon 7/27/15	Fri 1/8/16	2155
23	Miratimi i proceseve të sistemit	4 wks	Mon 1/11/16	Fri 2/5/16	22
24	➤ A3.2.5 Projektimi i Infrastrukturës	292 wks	Mon 6/1/15	Fri 1/1/21	
25	➤ A3.2.5.1 KRGJSH	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	
26	Rishikim i projektit për rrjetin Gjeodezik Aktiv	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	
27	Projektimi i rrjetit Gjeodezik Pasiv	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	2655
28	Projektimi i rrjetit të Nivelimit (Gjeoid, Gravimetrik)	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	2655
29	Projektimi i rrjetit të Stacioneve Mareografike	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	2655
30	Rrjeti i Stacioneve Magnetometrike	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	2655
31	➤ A3.2.5.2 GIS Kombëtar/ Lokal bazuar në INSPIRE/OGC	292 wks	Mon 6/1/15	Fri 1/1/21	
32	Katalogu i standardeve për Metadat	12 wks	Tue 9/1/15	Mon 11/23/15	
33	Standardet për rrjetin WMS	12 wks	Tue 11/24/15	Mon 2/15/16	32
34	Standardet për rrjetin WFS	12 wks	Tue 2/16/16	Mon 5/9/16	33
35	Standardet për shkëmbimin e të dhënave (GML)	8 wks	Tue 5/10/16	Mon 7/4/16	34
36	Modeli standard për Harduerët/Softuerët	12 wks	Tue 7/5/16	Mon 9/26/16	35
37	Projektimi i GIS Lokal	292 wks	Mon 6/1/15	Fri 1/1/21	
38	➤ A3.2.5.5 Gjeoportali Kombëtar bazuar në INSPIRE	16 wks	Mon 6/1/15	Fri 9/18/15	
39	Kërkesat për ekspertin e ToR	4 wks	Mon 6/1/15	Fri 6/26/15	
40	Përgatitja e ToR për Gjeoportalin Kombëtar	12 wks	Mon 6/29/15	Fri 9/18/15	39
41	➤ A3.3 Ndërtimi i NSDI	196 wks	Mon 6/1/15	Fri 3/1/19	
42	➤ A3.3.1 Ndërtimi i Kornizës Rregullatore	77.2 wks	Mon 6/1/15	Mon 11/21/16	
43	Rishikim i ligjit ekzistues	24 wks	Mon 6/1/15	Fri 11/13/15	
44	Aktet nënligjore për standardet e Metadave	8 wks	Tue 11/24/15	Mon 1/18/16	32
45	Aktet nënligjore për rrjetin WMS	8 wks	Tue 2/16/16	Mon 4/11/16	33
46	Aktet nënligjore për rrjetin WFS	8 wks	Tue 5/10/16	Mon 7/4/16	34
47	Aktet nënligjore për standardet e shkëmbimit të të dhënave (GML)	8 wks	Tue 7/5/16	Mon 8/29/16	35
48	Aktet nënligjore për modelin standard të Harduerëve/Softuerëve	8 wks	Tue 9/27/16	Mon 11/21/16	36
49	Rregullorja për Administrimin e GI	12 wks	Tue 8/30/16	Mon 11/21/16	47
50	Aktet nënligjore për transferimin e ALBPOS tek ASIG	4 wks	Tue 9/1/15	Mon 9/28/15	
51	➤ A3.3.2 Ndërtimi i Kornizës Institucionale të ASIG	48 wks	Mon 11/16/15	Fri 10/14/16	
52	Projektimi dhe miratimi i Strukturës së Re të ASIG	24 wks	Mon 11/16/15	Fri 4/29/16	43
53	Plotësimi i strukturës së ASIG me BNJ	24 wks	Mon 5/2/16	Fri 10/14/16	52
54	Përkrahimi dhe Punës	24 wks	Mon 5/2/16	Fri 10/14/16	5355
55	➤ A3.3.3 Ndërtimi i Manualit Administrativ të Procedurave	52 wks	Mon 2/8/16	Fri 2/3/17	
56	Përgatitja e Procedurave	24 wks	Mon 2/8/16	Fri 7/22/16	23
57	Zbatimi i Procedurave	12 wks	Mon 7/25/16	Fri 10/14/16	56
58	Monitorimi i Procedurave	12 wks	Mon 10/17/16	Fri 1/6/17	57
59	Rishikimi i Procedurave	4 wks	Mon 1/9/17	Fri 2/3/17	58
60	➤ A3.3.5.1 Ndërtimi i KRGJSH	180 wks	Mon 9/21/15	Fri 3/1/19	
61	Përmirësimi i Rrjetit Gjeodezik Aktiv	96 wks	Tue 1/5/16	Mon 11/6/17	50FS+14 wks
62	Rrjeti Gjeodezik Pasiv	70 wks	Mon 9/21/15	Fri 1/20/17	27
63	Rrjeti i Nivelimit (Gjeoid, Gravimetrik)	180 wks	Mon 9/21/15	Fri 3/1/19	28
64	Rrjeti i Stacioneve Mareografike	70 wks	Mon 9/21/15	Fri 1/20/17	29
65	Rrjeti i Stacioneve Magnetometrike	50 wks	Mon 9/21/15	Fri 9/2/16	30
66	➤ A3.3.5.2 Ndërtimi i GIS Kombëtar	62 wks	Tue 7/5/16	Mon 9/11/17	
67	Softuerë për GIS	50 wks	Tue 7/5/16	Mon 6/19/17	35
68	Harduerë për GIS	20 wks	Tue 9/27/16	Mon 2/13/17	36
69	Trajnimi i stafit për përdorimin e GIS	12 wks	Tue 6/20/17	Mon 9/11/17	67
70	➤ A3.3.5.5 Ndërtimi i Gjeoportalit Kombëtar	94 wks	Mon 9/21/15	Fri 7/7/17	
71	Softuerë për Gjeoportalin Kombëtar	44 wks	Mon 9/21/15	Fri 7/22/16	40



72	Harduerë për Gjeoportalin Kombëtar	20 wks	Mon 9/21/15	Fri 2/5/16	7155
73	Trajnimi i stafit për përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar	16 wks	Mon 7/25/16	Fri 11/11/16	71
74	Fushata e Informimit	50 wks	Mon 7/25/16	Fri 7/7/17	71
75	➤ A3.4 Gjeoinformacioni	339 wks	Mon 6/1/15	Fri 11/26/21	
76	➤ A3.4.1 Standardet e GI	192 wks	Mon 6/1/15	Fri 2/1/19	
77	A3.4.1.1 Sistemi i Adresave	12 wks	Mon 2/8/16	Fri 4/29/16	93
78	A3.4.1.2 Kufijtë e Njësisve Administrative	12 wks	Mon 6/1/15	Fri 8/21/15	8255
79	A3.4.1.3 Parcelat Kadastrale	12 wks	Mon 8/24/15	Fri 11/13/15	78
80	A3.4.1.4 Sistemet e Rrjetëve Gjeografike	12 wks	Mon 12/11/17	Fri 3/2/18	89
81	A3.4.1.5 Emërtimet Gjeografike	12 wks	Mon 5/2/16	Fri 7/22/16	77
82	A3.4.1.6 Hidrografia	12 wks	Mon 6/1/15	Fri 8/21/15	
83	A3.4.1.7 Zonat e Mbrojtura	12 wks	Mon 7/25/16	Fri 10/14/16	81
84	A3.4.1.8 Rrjetet e Transportit	12 wks	Mon 11/16/15	Fri 2/5/16	86
